



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 27

Tiranë – E martë, 11 shkurt 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 27, datë 7.2.2025	Për dhënie grade madhore..... 3103
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 5.2.2025	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2026-2028..... 3103
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 4, datë 4.2.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”..... 3116
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit nr. 80, datë 31.12.2024	Për delegim kompetence..... 3149
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 94, datë 31.1.2025	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 3149
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit nr. 10, datë 8.1.2025	Për delegim kompetence..... 3150

**DEKRET**
Nr. 27, datë 7.2.2025**PËR DHËNIE GRADE MADHORE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “d”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 3, shkronja “a”, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, datë 30.12.2024,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Kundëradmiral Adnand Dëfrim Agastra, me detyrë “Komandant i Forcës Detare”, i jepet grada madhore “Nënadmiral”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 83, datë 5.2.2025**PËR MIRATIMIN E KUADRIT**
MAKROEKONOMIK E FISKAL PËR
PERIUDHËN 2026–2028

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2026–2028, sipas lidhjes nr. 1 “Treguesit kryesorë makroekonomikë”, dhe lidhjeve nr. 2/1 e nr. 2/2 “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KUADRI MAKROEKONOMIK
DHE FISKAL 2026–2028
JANAR, 2025**Tabela e përmbajtjes**

Shkurtime

Hyrje

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

2. Politikat fiskale

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Lidhja nr. 1. Treguesit kryesorë makroekonomikë

Lidhja nr. 2/1. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Lidhja nr. 2/2. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Shkurtime

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal
LOB	Ligji Organik i Buxhetit
MF	Ministria e Financave
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO	World Economic Outlook

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF) për periudhën 2026–2028 është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projektton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor



afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e taveve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 në nivel ministrie.


KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA-së dhe të taveve për shpenzimet.

KMF-ja përmban dy komponentë kryesorë: i. parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vjetët e ardhshëm; dhe ii. parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskalë, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë për vitet 2026–2028 dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht lidhja nr. 1; lidhja nr. 2/1; dhe lidhja nr. 2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ekonomia e vendit ka treguar një qëndrueshmëri dhe elasticitet të konsiderueshëm përballë sfidave të njëpasnjëshme që kanë goditur vendin gjatë viteve të fundit. Kjo qëndrueshmëri është vënë në provë nga tri kriza madhore që ndodhën në mënyrë të njëpasnjëshme, si: tërmeti, pandemia globale dhe ndërprerjet në furnizimin e mallrave bazë si pasojë e luftës në Ukrainë. Pavarësisht këtyre sfidave, politikat e kujdesshme makroekonomike kanë mbështetur një rikthim të fortë ekonomik, dhe si rezultat fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare, si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit kanë mbetur solide. Përballë një mjedisi ekonomik sfidues, të karakterizuar nga çmime relativisht të larta, pasiguri dhe kosto të larta financimi, ekonomia ka ruajtur një normë të qëndrueshme rritjeje, duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Performanca ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë pozitive dhe relativisht e lartë, duke shfaqur një trajektore premtuese dhe pritet të vazhdojë ecurinë pozitive edhe në periudhën afatmesme.

Në vitin 2022, norma e rritjes ekonomike arriti në 4.8 për qind, duke shënuar një performancë të fortë. Trendi pozitiv i rritjes ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023, duke pasur një normë rritjeje vjetore prej 3.9 për qind, duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2024, ekonomia e vendit vijoi sërish të performojë me një rritje pozitive. Sipas vlerësimeve më të fundit të INSTAT-it, Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) real u rrit me 3.97 për qind në terma vjetorë në tremujorin e parë të vitit 2024, duke u përshpejtuar lehtë në tremujorin e dytë dhe të tretë në nivelin prej 4.1 për qind, krahasuar me tremujorët respektivë të vitit 2023. Në terma kumulativë për nëntëmujorin e vitit 2024, PBB-ja reale shënoi një rritje prej 4.0 për qind kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2023.



Në tërësi, rritja ekonomike gjatë kësaj periudhe duket të jetë gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat, po ashtu edhe nga investimet, si dhe nga ecuria mjaft e mirë e eksporteve të shërbimeve (veçanërisht turizmi). Ky dinamizëm është reflektuar në një zgjerim të ndjeshëm të aktivitetit ekonomik në sektorin e shërbimeve dhe atë të ndërtimit.

Sipas optikës së kërkesës agregate, konsumi final total për nëntëmujorin 2024 ka shënuar rritje 3.95 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 3.65 për qind. Ndërkohë, vetëm për tremujorin e tretë konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan një normë rritje në respektivisht 1.7 për qind dhe 0.83 për qind.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) shënoi rritje me rreth 4.4 për qind në terma realë vjetorë përgjatë nëntë muajve të vitit 2024, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2024 kjo normë ishte 4.52 për qind.



Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT-it, përgjatë nëntë muajve të vitit 2024, eksportet e mallrave dhe shërbimeve kanë pasur rënie prej rreth 0.5 për qind, ku respektivisht eksportet e mallrave kanë shënuar një rënie prej rreth 14.0 për qind, ndërsa eksportet e shërbimeve janë rritur me rreth 3.2 për qind. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve kanë shënuar një normë të fortë rritjeje prej rreth 6.74 për qind.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, sektorët të cilët kanë shënuar rritjen më të fortë përgjatë periudhës nëntëmujore të vitit 2024, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Aktivitete profesionale dhe shërbime administrative” me rritje prej 10.77 për qind; “Administrimi publik, Arsimi dhe Shëndetësia” me rritje prej 8.88 për qind; “Ndërtimi” me rritje prej 8.11 për qind; “Tregti, transport, akomodimi dhe shërbimi ushqimor” me rritje prej 6.13 për qind; “Aktivitete financiare dhe të sigurimit” me rritje prej 6.25 për qind etj. Ndër sektorët që kanë pësuar rënie janë: “Industria” me rënie prej -6.86 për qind dhe “Bujqësia, pyjet dhe peshkimi” me rënie prej -0.84 për qind.

Zhvillimet në tregun e punës kanë qenë pozitive dhe në rikuperim të vijueshëm pas valës së rënies së aktivitetit ekonomik shkaktuar nga pandemia. Këto trende pasqyrojnë dinamikën pozitive të situatës së përgjithshme ekonomike në Shqipëri. Gjatë vitit 2023¹, shkalla e papunësisë ka vijuar të ulet, ndërsa punësimi është rritur mesatarisht me 1.6 për qind në vit, mbështetur kryesisht nga punësimi më i lartë në sektorin e shërbimeve. Në vitin 2023, norma e pjesëmarrjes në tregun e punës arriti në 75.7 për qind, ndërsa norma e punësimit u rrit në 67.2 për qind, krahasuar me 73.3 për qind dhe 65 për qind në të njëjtën periudhë të vitit 2022. Evidencat tregojnë se ka një interes të përgjithshëm në rritje për pjesëmarrje në tregun e punës, i nxitur nga trendi rritës i pagave, duke intensifikuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë vijoi trendin rënës të viteve të fundit dhe është ulur deri në 11.2 për qind (ose në 10.7 për qind për moshën 15 vjeç e lart) në tremujorin e katërt 2023, nga 11.3 për qind në fund të vitit të kaluar (ose nga 11 për qind për moshën 15 vjeç e lart). Kjo paraqet shifrën më të ulët të papunësisë të regjistruar historikisht.



Burimi: INSTAT


Ndërsa statistikat zyrtare nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës (ATP) për nëntëmujorin e parë të vitit 2024 ende nuk janë të disponueshme², treguesit administrativë të tregut të punës sugjerojnë për rritje të punësimit me 1.4 për qind për këtë periudhë, e udhëhequr kryesisht nga punësimi në sektorin privat.

Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, Bilanci i Pagesave (BP) për vitin 2023 regjistroi një suficit prej rreth 937 milionë eurosh, ndërsa për nëntëmujorin e vitit 2024 bilanci i pagesave regjistroi një deficit prej afro 30 milionë euro, kundrejt një suficiti prej 786 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Deficiti i llogarisë korrente për nëntëmujorin e parë të vitit 2024 u zgjerua në 230 milionë euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte 23 milionë euro.

Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2024, llogaria korrente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 350 milionë eurosh, përkundrejt pothuajse të njëjtën nivel prej 355 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në sfondin e zgjerimit të konsiderueshëm të suficitit tregtar në shërbime. Përmirësimi i llogarisë korrente në masë të konsiderueshme u ndikua nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime dhe zgjerimi i balancës pozitive të të ardhurave dytësore (kryesisht remitancat), faktorë të cilët kompensuan plotësisht deficitin tregtar në mallra dhe zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore (të ardhurat dalëse kryesisht nga stoku i investimet të huaja neto).

¹ Këto janë të dhënat më të fundit të disponueshme deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti.

² Statistikat e tregut të punës janë në proces rishikimi dhe kuadrimi nga INSTAT-i me censin (e ri) e popullsisë 2023.



Nga ana tjetër, deficitit tregtar rezultoi me një zgjerim prej rreth 728 milionë eurosh ose 22.7 për qind krahasuar me nëntëmujorin e 2023-shit. Eksporti i mallrave për nëntëmujorin 2023 u ul me 3.5 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023, por në të njëjtën kohë importi i mallrave u zgjerua me rreth 14.6 për qind, në reflektim të rritjes së kërkesës së brendshme stimuluar edhe nga sezoni turistik, duke çuar për rrjedhojë në zgjerimin e deficitit tregtar. Shkëmbimet tregtare në shërbime vijuan në trend pozitiv, duke zgjeruar suficitin tregtar, me rreth 14 për qind në terma vjetorë, në nivelin 1.5 miliardë euro. Eksporti i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjerua në vlerën 3.8 miliardë euro për nëntëmujorin 2024, ose rreth 20.0 për qind më shumë krahasuar me 3.2 miliardë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Remitancat për periudhën nëntëmujore të vitit 2024 shënuan vlerën 772 milionë euro, me një rritje prej rreth 14.2 për qind krahasuar me 676 milionë euro në periudhën respektive të një viti më parë. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2024, teprica pozitive e llogarisë financiare dhe kapitale rezultoi në 122 milionë euro krahasuar me 741 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj llogarie, investimet e huaja direkte hyrëse shënuan nivelin prej 1.16 miliardë eurosh për nëntëmujorin e parë të vitit 2024, ose një rritje prej 5.1 për qind në krahasim me nivelin prej 1.10 miliardë eurosh të së njëjtës periudhë të 2023-shit.

Inflacioni i çmimeve të konsumit vazhdoi prirjen rënëse të shpejtë gjatë vitit 2024. Rënia u nxit si nga vlerësimi i vazhdueshëm i lekut, veçanërisht kundrejt euros, monedhës kryesore të shkëmbimeve tregtare, ashtu edhe prej goditjeve pozitive të ofertës së jashtme, të reflektuara në rënien e inflacionit të çmimeve të ushqimeve dhe më tej, si dhe nga rënia

e çmimeve të naftës gjatë muajve të fundit. Sa u përket të dhënave më të fundit të disponueshme, në muajin dhjetor 2024 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2.1 për qind, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte 4.0 për qind. Inflacioni mesatar për periudhën janar–dhjetor të vitit 2024 është 2.2 për qind.



Burimi: INSTAT

Ndërsa kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore ka shënuar një vlerësim të ndjeshëm edhe gjatë vitit 2024, duke theksuar tendencën forcuese të vërejtur në vitet e mëparshme. Kursi mesatar lekë/euro për janar–dhjetor 2024 ishte 100.7 nga 108.75 që ishte mesatarisht gjatë së njëjtës periudhë të 2023. Ndërsa kursi mesatar lekë/USD për janar–dhjetor 2024 ishte 93.04 nga 100.62, që ishte mesatarisht gjatë së njëjtës periudhë të 2023-shit. Presionet e vazhdueshme për forcimin e kursit vijuan të burojnë nga rritja e flukseve hyrëse valutore të ushqyera nga rritja e turizmit, remitancave dhe IHD-ve.

2. Politika fiskale

Pas një stimuli të lartë, për të kryer një politikë fiskale ekspansioniste të domosdoshme dhe njëkohësisht të paevitueshme gjatë viteve 2020 dhe 2021, me qëllim amortizmin e goditjeve negative (nga tërmeti dhe sidomos pandemia), politika fiskale u rikthye qartësisht drejt konsolidimit gjatë viteve 2022–2024. Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2026–2028, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Me synimin për të ruajtur të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, politika fiskale do të targetojë një trajktore rënëse të




përvitshme të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv në vijimësi, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskale respektive në LOB.

Kuadrat shpjegues 1. Balanca primare, ankora kryesore e politikës fiskale

Balanca primare është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, për të cilën, në korrik të 2020 u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore, duke përfshirë një rregull të re fiskale në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të *acquis* të BE-së, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë, që duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënese të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal, me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mirëfunksionimin e përgjithshëm të ekonomisë së vendit.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, ky kuadër synon të ruajë një raport të balancuar dhe të qëndrueshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) për periudhën 2026–2028 do të targetohen të jenë mesatarisht rreth 5.9 për qind e PBB-së në çdo vit buxhetor. Kjo përfshin, gjithashtu, investimet e reja publike, të cilat mund të realizohen në kuadër të planit të ri të rritjes së implementuar nga Bashkimi Evropian. Ky nivel i shpenzimeve kapitale tejkalon qartë deficitin e përgjithshëm fiskal të periudhës, duke targetuar në këtë mënyrë në mënyrë konsistente një balancë fiskale korrente pozitive, në përputhje me rregullën e artë të buxhetit. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2026–2028 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit (shih kuadratin shpjegues 2, në faqen 10).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 1.9 për qind të PBB-së për 2026-n, nga 2.6 për qind i programuar për vitin 2025; nivelin prej 1.6 për qind të PBB-së në vitin 2027 dhe 1.0 për qind në 2028-n. Njëkohësisht, pasi tashmë e targetuar në një nivel neutral prej 0.0 për qind e PBB-së për vitin 2025 (sipas ligjit të buxhetit 2025), balanca primare në periudhën afatmesme do të targetohet në vijimësi në vlera pozitive, respektivisht 0.7 për qind e PBB-së për vitin 2026 në, 0.9 për qind në vitin 2027 dhe 1.4 për qind në vitin 2028.





Duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të KMF-së aktuale, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objektivi (rregull fiskale) të parametrut të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik bruto rreth nivelit prej 52.1 për qind të PBB-së deri në vitin 2028 nga rreth 55.2 për qind që pritet të rezultojë në 2024.

Kuadrat shpjegues 2: Mbi përputhshmërinë me rregullat fiskale

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936/2008, të ndryshuar, KMF 2026–2028 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Rregulla e “Qëndrueshmërisë së borxhit”: Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të PBB-së.

Në përputhje me këtë rregull fiskale të LOB-së, kuadri fiskal 2026–2028 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se niveli i vitit pararendës.**

2. Rregulla e “Balancës primare”: Duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk mund të jetë negative; duhet të jetë së paku zero ose pozitive (tepricë primare).

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull të re fiskale) të LOB-së, **kuadri fiskal për periudhën 2026–2028 targeton një balancë primare neutrale prej 0.7 për qind në vitin 2026, 0.9 për qind në vitin 2027 dhe 1.4 për qind në vitin 2028.**

3. “Rregulla i artë”: Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale, të miratuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregulla fiskale – “rregulla e artë”) të LOB-së, deficit i targetuar vjetor në këtë kuadër fiskal për periudhën 2026–2028 është **çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca fiskale korrente e targetuar është pozitive çdo vit mesatarisht +4.4 për qind e PBB-së.

4. Parashikime makroekonomike të kujdesshme: Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva Ekonomike Botërore” (World Economic Outlook – WEO), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit.

Në përputhje me rregullën fiskale të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), Kuadri Makroekonomik e Fiskal 2026–2028 mbështetet në projeksionet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nominal të cilat nuk janë më të mëdha krahasimisht me projeksionet respektive më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Në këtë cikël të programimit për Kuadrin Makroekonomik e Fiskal afatmesëm, ankorimi i projeksioneve të PBB-së nominal, siç kërkohet nga kjo rregull fiskale, është realizuar kundrejt projeksioneve më të fundit (zyrtare) të FMN-së, të paraqitura në Raportin e Stafit për Konsultimet e Artikullit IV të vitit 2024. Këto projeksione janë më të fundit të përpiluara dhe publikuara zyrtarisht nga FMN (misioni respektiv i FMN-së u realizua në fund të muajit nëntor 2024, ndërsa raporti i stafit u publikuar në janar 2025).

Tabela e mëposhtme paraqet krahasueshmërinë e projeksioneve të Ministrisë së Financave me ato përkatëse të FMN-së, duke demonstruar përputhshmërinë me këtë rregull fiskale të LOB-it.

Parashikimet e PBB nominale të MF dhe FMN	(në miliardë Lekë)						
	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
			Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
MF	2,149.7	2,369.9	2,494.2	2,620.7	2,756.7	2,898.1	3,041.3
FMN	2,149.7	2,369.9	2,539.0	2,678.0	2,855.0	3,045.0	3,248.0
Diferenca MF - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.0	-44.8	-57.3	-98.3	-146.9	-206.7

5. Planifikim kontigjence: Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kursat e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskale) të LOB-së, kuadri fiskal për periudhën 2026–2028 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit etj.” **një kontigjencë prej mbi 0.7 për qind e shpenzimeve totale.**

6. Të ardhura nga privatizimi: Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programi buxhetor. Në rast se arkëtohen, ato përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa e mbetur për investime publike.



3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik, mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë në kontekstin e ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si INSTAT-i, BSH-ja, MF-ja, FMN-ja, BB-ja, Eurostatit etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme për të ndodhur, dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre vjetëve në vijim nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomikë të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajektore rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor një balancë primare së paku neutrale (ose me suficit) në çdo vit buxhetor në vijimësi. Ky objektiv është ligjërish i detyrueshëm në LOB.

- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 5 për qind të PBB-së mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektivi themelor i politikës monetare, e cila targeton një

normë inflacioni në nivelin 3.0 për qind, në një periudhë afatmesme dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizimin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare, me qëllim për të mbështetur një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit.


- Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 6 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij kuadri makroekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recesionit të fortë prej -3.3 për qind në vitin 2020, ekonomia u rimëkëmb fuqishëm në vitin 2021, duke shënuar rritje reale prej 9.0 për qind dhe duke vijuar trendin pozitiv edhe gjatë viteve 2022 dhe 2023, përkatësisht në 4.8 për qind dhe 3.9 për qind. Për vitin 2024 kjo rritje vlerësohet të jetë rreth 3.9 për qind dhe pritet të vijojë trendin pozitiv edhe në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në normën 3.9 për qind për vitin 2025 dhe përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2026–2028 parashikohet mesatarisht rreth 4.0 për qind në vit. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 4.0, 3.9 dhe 4.1 për qind respektivisht për vitet 2026, 2027 dhe 2028.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport-import) pritet të ketë një efekt pozitiv. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, veçanërisht pas rikthimit në nivelet normale të inflacionit gjatë vitit 2024.



Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi sërish i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies gradualisht përgjatë afatit të mesëm priten të jenë faktorë të rëndësishëm incentivues i investimeve private.


Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2026–2028) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht rreth 3.0 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.5 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa

investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë mesatarisht në rreth 4.6 për qind në vitet 2026–2028, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.1 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të kenë performancë pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa u takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2026–2028, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 4.8 për qind në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.9 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 3.2 për qind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së me rreth 1.5 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut të moderuar pozitiv në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.4 pikë përqindjeje në vit.

Grafiku 3.1 Rritja reale (majtas, në për qind) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të kërkesës agregate




Burimi: Ministria e Financave

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, objektivi tjetër i kësaj politike fiskale për të ruajtur një nivel relativisht të lartë të investimeve publike në mbi 5 për qind të PBB-së në vitet 2026–2028, do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta e të qëndrueshme të rritjes ekonomike në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut për financat publike dhe ekonominë në tërësi dhe do të rrisë hapësirat për zgjerimin e aktivitetit në sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritje të lartë e të qëndrueshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht: bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 0.3 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2026–2028, duke mos kontribuar pothuajse fare në rritjen ekonomike; industria me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.0 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.5 pikë përqindjeje; ndërtimi me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.2 për qind dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.4 pikë përqindjeje; shërbimet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.0 për qind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.5 pikë përqindjeje.


Grafiku 3.2 Rritja reale (majtas, në përqindje) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.) sipas komponentëve të ofertës agregate



Burimi: Ministria e Financave

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 0.1 për qind në vit gjatë viteve 2026–2028. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës, ndërkohë që trendet negative demografike (të vërejtura prej disa vjetësh tashmë) pritet të vijnë në kenë efekte shtrënguese si në ofertën për punë, ashtu edhe në numrat agregatë të punësimit përgjatë periudhës afatmesme në vijim.

Grafiku 3.3 Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në përqindje) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në përqindje)



Burimi: Ministria e Financave


Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë dinamikën e perspektivës afatmesme të sektorëve kryesorë të aktivitetit ekonomik, të përmendur më sipër. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Ndërkohë pritet që punësimi në afatin e mesëm të jetë së paku jo në rritje negative (në nivele mjaft të moderuara, por gjithsesi ende pozitiv), në reflektim të efekteve të kundërta të rritjes së shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës nga njëra anë dhe trendeve negative demografike nga ana tjetër. Në të njëjtën kohë pritet që produktiviteti i përgjithshëm i punës të vijojë një përmirësim të konsiderueshëm gjatë kësaj periudhe dhe të jetë një faktor i rëndësishëm i gjenerimit të rritjes ekonomike në afatin e mesëm. Kjo, duke reflektuar si vijimin e lëvizjeve të forcave të punës drejt sektorëve me produktivitet relativ më të lartë se të tjerët, ashtu edhe në reflektim të vijimit të përmirësimeve teknologjike ekonomike, përfshirë këtu patjetër edhe vijimësinë e përmirësimeve infrastrukturore dhe vijimësinë e reformave strukturore.

Në skenarin bazë parashikohet (supozohet) se inflacioni do të rikthehet drejt targetit të tij prej 3 për qind gjatë vitit 2025 dhe do të qëndrojë rreth këtij niveli për periudhën afatmesme 2026–2028.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur VKM-së.


Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave dhe ndryshimeve fiskale (tatimore) të ndërmarra dhe veçanërisht ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vitet në vijim (2026–2028) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 5.3 për qind në çdo vit. Më specifikisht: 5.5 për qind për vitin 2026, 6.2 për qind për vitin 2027 dhe 4.2 për qind për vitin 2028. Ndërsa të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.4 për qind.

Grafiku 3.4 Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqindje të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vjetët në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave kryesorë të sipërpërmendur të politikës fiskale për këtë periudhë (balanca primare, deficit fiskal, borxhi publik), burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2026–2028 pritet të jenë mesatarisht në rreth 885.8 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 30.6 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 5.9 për qind të PBB-së në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

**Grafiku 3.5 Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqindje të PBB-së)**

Burimi: Ministria e Financave

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur VKM-së, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.

Lidhja nr. 1. Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
					Vler.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Million	2.5	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4
Inflacioni (mesatar)	%	2.0	6.7	4.8	2.2	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	3.4	9.9	6.1	1.3	1.2	1.2	1.2	0.8
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	103.5	113.0	100.6	93.1	93.1	93.1	93.1	93.1
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	122.5	119.0	108.8	100.7	100.7	100.7	100.7	100.7
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	42.5	41.5	41.5	41.5	41.5	41.5	41.5	41.5
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	66.6	65.5	65.5	65.5	65.5	65.5	65.5	65.5
Rritja reale e PBB	%	9.0	4.8	3.9	3.9	3.9	4.0	3.9	4.1
PBB	Lek miliardë	1,866.7	2,149.7	2,369.9	2,494.2	2,620.7	2,756.7	2,898.1	3,041.3
PBB	USD miliardë	18.0	19.0	23.5	26.8	28.2	29.6	31.1	32.7
PBB	Euro miliard	15.2	18.1	21.8	24.8	26.0	27.4	28.8	30.2
PBB për banor	Lek mijë	750.9	879.6	986.6	1,041.6	1,098.3	1,159.9	1,224.8	1,290.9
PBB për banor	USD	7,253.6	7,781.1	9,802.7	11,192.0	11,801.4	12,463.0	13,160.7	13,871.0
PBB për banor	Euro	6,131.7	7,392.7	9,067.9	10,342.3	10,905.4	11,516.7	12,161.5	12,817.8
PBB për banor	USD-PPP	17,667.2	21,219.5	23,801.0	25,128.1	26,496.4	27,981.7	29,548.1	31,142.9
PBB për banor	Euro-PPP (EU=27)	11,279.6	13,423.6	15,056.6	15,896.1	16,761.7	17,701.3	18,692.2	19,701.1
Shkalla e papunësisë (15-64 vjec)	%	12.0	11.3	11.2	10.2	9.8	9.5	9.3	9.0
Të ardhurat totale	% të PBB	27.4	26.6	27.2	28.6	28.9	29.0	29.3	29.1
Shpenzimet totale	% të PBB	31.9	30.3	28.5	30.1	31.5	30.8	30.8	30.1
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-4.6	-3.6	-1.3	-1.5	-2.6	-1.9	-1.6	-1.0
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-2.7	-1.8	0.7	0.7	0.0	0.7	0.9	1.4
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	2.3	1.6	3.7	3.6	3.6	4.2	4.5	4.6
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	70.2	63.5	55.5	53.0	53.1	52.5	51.5	50.4
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	74.1	64.1	57.5	55.2	54.8	54.0	53.2	52.1
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	71.1	61.7	55.8	53.7	53.3	52.5	51.6	50.3
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	3.0	2.4	1.7	1.5	1.4	1.5	1.5	1.7
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-7.7	-5.9	-1.2	-2.7	-3.7	-3.1	-3.1	-3.2
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-13.3	-10.3	-5.4	-7.8	-8.0	-7.2	-7.1	-6.7
Mallra	% të PBB	-25.1	-23.6	-20.8	-24.1	-24.0	-23.4	-23.5	-23.4
Eksperte	% të PBB	8.3	10.7	8.4	7.4	7.4	7.5	7.6	7.7
Importe	% të PBB	-33.4	-34.3	-29.3	-31.5	-31.4	-31.0	-31.2	-31.1
Bilanci i pagesave	% të PBB	6.1	-0.4	4.3	4.0	2.4	2.6	1.9	2.1
Rezervat valutore	Euro milion	4,972.2	4,952.1	5,888.9	6,882.1	7,494.4	8,210.0	8,753.4	9,385.9
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	8.8	6.9	7.4	7.1	7.4	7.8	7.9	8.1

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore, Eurostat



Lidhja nr. 2/1. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	E M E R T I M I	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
					I Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	510,951	572,790	643,678	714,306	757,036	798,513	848,393	884,257
I.	Ndihmat, nga të cilat:	13,050	9,510	22,431	11,757	18,995	20,296	30,078	23,911
	prej New Growth Plan					2,395	3,696	13,478	7,261
II.	Të ardhura tatimore	475,612	541,342	598,662	660,137	712,240	751,567	791,966	833,826
II.1	Nga tatimet dhe doganat	338,074	390,893	422,491	459,191	501,573	531,827	563,760	595,531
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	26,666	27,638	31,686	39,314	40,774	43,931	46,333	49,085
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	110,872	122,811	144,485	161,632	169,893	175,808	181,873	189,210
III.	Të ardhura jo-tatimore	22,289	21,938	22,585	42,412	25,800	26,650	26,350	26,520
	TOTALI I SHPENZIMEVE	596,279	651,015	674,857	751,955	825,088	849,803	893,338	914,343
I.	Shpenzime Korrente	461,065	499,989	547,039	619,436	656,014	679,739	709,612	735,795
I.1	Personeli	83,268	84,696	100,476	114,852	127,929	133,069	138,010	144,380
	Paga	71,179	72,103	85,945	97,800	109,275	109,450	109,807	110,357
	Kontributi për sigurime shoqërore	11,403	11,784	13,537	15,784	17,254	18,100	18,834	19,134
	Fondi i veçantë i pagave				268	400	500	500	500
	Politika të reja pagash							3,600	3,600
	Indeksimi i pagave						4,019	4,269	9,789
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	686	808	995	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
I.2	Interesat	35,822	39,624	47,591	54,908	68,552	70,148	71,550	73,728
	Të brendshme	23,470	24,210	29,030	33,344	37,906	39,525	40,809	42,216
	Të huaja	12,352	15,414	18,561	21,564	24,866	24,623	24,241	25,013
	Kontingjencë për risqet e borxhit					5,780	6,000	6,500	6,500
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	59,363	68,505	70,489	84,394	75,684	76,551	77,015	77,585
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)				80,794	71,884	72,651	73,015	73,485
	Arsimi i lartë				1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Të tjera jashtë limitit				2,600	2,800	2,900	3,000	3,100
I.4	Subvencionet	1,422	1,650	1,906	1,674	1,950	1,950	1,950	1,950
I.5	Shpenzime për fondet speciale	199,457	216,515	226,788	251,556	263,838	274,843	292,944	304,114
	Sigurime shoqërore	148,030	163,037	170,239	187,825	192,338	202,888	213,538	223,188
	Politika të reja pensionesh					1,618	1,703	2,053	2,773
	Bonusi i pensionistit					3,750	3,800	7,350	7,400
	Sigurime shëndetësore	49,130	52,244	55,213	58,731	63,132	63,452	64,003	64,753
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	2,297	1,234	1,336	5,000	3,000	3,000	6,000	6,000
I.6	Buxheti lokal	52,585	58,694	68,841	81,250	89,911	94,578	98,493	103,638
	Transferta nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	25,226	29,257	33,191	36,888	43,137	44,447	45,961	48,003
	Transferte të pakushtëzuar e përgjithshme				24,773	26,207	27,567	28,981	30,413
	Transferte të pakushtëzuar sektoriale (Grant Specificik)				10,615	13,230	16,880	16,980	17,590
	Transferte sektoriale për pagat, etj.				1,500	3,700			
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	25,791	28,198	34,905	39,314	40,774	43,931	46,333	49,085
	Taksa të ndara				1,478	1,500	1,500	1,500	1,650
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				3,000	3,000	3,200	3,200	3,400
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	404	676	530	570	1,500	1,500	1,500	1,500
	Shpenzime nga të ardhura të paplanifikuara (kap6/te mbartura)	1,164	563	215					
I.7	Transferta të tjera	29,149	30,306	30,948	30,802	28,150	28,600	29,650	30,400
	Pagesa e papunësisë	952	746	858	835	800	800	800	900
	Ndihma ekonomike dhe politike e femijeve, etj	23,981	25,464	25,686	24,500	23,700	23,900	24,550	25,000
	Kompensim për të pëmdjekurit politikë	913	996	1,098	1,100	1,400	1,600	2,000	2,000
	Shperblimi i familjeve ne nevojë				2,167				
	Bonusi i lindjeve	3,303	3,100	3,306	2,200	2,250	2,300	2,300	2,500
II.	Fondi rezervë	461	0	0	0	6,700	2,500	7,500	9,000
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave					3,000	2,500	5,000	5,000
	Rezerve për zgjedhjet					2,500		2,500	
	Kontigjence								4,000
	Fond rezerve për reformat/masat e New Growth Plan					1,200			
III.	Shpenzime kapitale	128,044	112,119	119,053	126,219	162,374	167,564	176,226	169,548
	Financimi i brendshëm	72,116	63,675	88,489	91,389	112,811	112,466	97,812	97,222
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	708	892	602	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Financimi i huaj, nga të cilat:	25,699	18,676	13,761	24,830	43,563	49,098	75,414	66,326
	në sektorin e energjisë	1,537	567	873	2,000	2,000	2,000	2,000	2,000
	prej New Growth Plan					4,463	6,886	25,114	13,529
	Trans kapitale për llog. speciale të shpronësimeve							2,000	5,000
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:	29,521	28,877	16,201	9,000	5,000	5,000		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)	29,521	28,877	16,201	9,000	5,000	5,000		
V.	Të tjera	3,709	27,907	3,766	0	0	0	0	0
	Hua e dhene për sis. energji. e të tjera nga burimet e brendshme		7,907						
	Mbeshtetje buxhetore për sektorin energjitik		20,000						
VI.	Fond shpronësimi	3,000	11,000	5,000	0	0	0	0	0
VII.	Transferte për Llogarinë e Fondit të Pensioneve në BSH				6,300				
	DEFIÇITI	-85,328	-78,226	-31,180	-37,649	-68,052	-51,291	-44,945	-30,086
	FINANCIMI DEFIÇITIT	85,328	78,226	31,180	37,649	68,052	51,291	44,945	30,086
I.	I brendshëm	-18,701	87,765	-7,324	52,349	60,566	46,760	26,563	20,230
	Të ardhura nga privatizimi	306	191	47					
	Hua-marje e brendshme (neto)	48,705	26,156	20,671	50,000	50,000	45,000	30,000	25,000
	Të tjera, nga të cilat:	-67,712	61,417	-28,043	2,349	10,566	1,760	-3,437	-4,770
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	-72,713	41,467	-41,046	-7,651	10,566	1,760	-3,437	-4,770
	Ndryshimi i gjendjes së depozitës sig. Shogq&Shend				10,000				
II.	I huaj	104,029	-9,539	38,504	-14,700	7,486	4,531	18,381	9,856
	Hua afatgjatë (e marrë)	93,491	11,140	72,476	15,600	87,496	31,303	108,264	105,394
	Per projekte, nga të cilat:	14,561	11,140	9,703	15,030	26,068	30,303	46,836	43,966
	prej New Growth Plan					2,068	3,191	11,636	6,269
	Eurobond	78,527		61,668		60,428		60,428	60,428
	Nen-hua (Pushiteti vendor)	404	676	530	570	1,000	1,000	1,000	1,000
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	1,161	589	51					
	Ripagesat	-33,164	-38,386	-53,238	-41,379	-100,153	-36,843	-99,954	-95,538
	Eurobond			-14,470		-36,962		-65,464	-60,428
	Maturim					-36,962		-65,464	-60,428
	Para-bletje			-13,670					
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	42,541	17,117	19,215	11,078	20,143	10,071	10,071	
	MEMO:								
	Balanca e përgjithshme (deficitit përgjithshëm)	-85,328	-78,226	-31,180	-37,649	-68,052	-51,291	-44,945	-30,086
	Balanca korente	42,716	33,893	87,873	88,570	94,321	116,273	131,281	139,462
	Balanca primare	-49,506	-38,602	16,411	17,259	500	18,857	26,605	43,642
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	72,635	14,504	48,419	56,070	45,504	43,744	47,181	51,951
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	1,310,305	1,364,121	1,314,408	1,321,259	1,390,312	1,446,092	1,493,257	1,531,574
	Borxhi publik BRUTO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	1,382,940	1,378,626	1,362,828	1,377,330	1,435,816	1,489,836	1,540,438	1,583,525
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,327,729	1,326,201	1,321,390	1,340,569	1,398,055	1,447,586	1,495,967	1,530,823
	I brendshëm (stok)	678,881	712,779	725,399	775,399	825,399	870,399	900,399	925,399
	I huaj (stok)	648,848	613,421	595,991	565,170	572,656	577,187	595,569	605,425
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	55,211	52,425	41,438	36,761	37,761	42,250	44,471	52,701
	Pushiteti vendor (stok)	315	204	101	900	900	900	1,000	1,000
	Borxhi publik i garantuar (stok)	54,896	52,221	41,337	35,861	36,861	41,350	43,471	51,701
	Efekt rëniesimi nga ndryshimi kursit këmbimit (fluks)	0	0	0	-16,120	0	0	0	0
	PBB nominal	1,866,674	2,149,741	2,369,906	2,494,208	2,620,732	2,756,663	2,898,066	3,041,261

Burimi: Ministria e Financave



Lidhja nr. 2/2. Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Nr.	EMËRTIMI	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
					I Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
I.	TOTALI TË ARDHURAVE	27.4	26.6	27.2	28.6	28.9	29.0	29.3	29.1
I.	Ndihmat, nga të cilat:	0.7	0.4	0.9	0.5	0.7	0.7	1.0	0.8
	prej New Growth Plan					0.1	0.1	0.5	0.2
II.	Të ardhura tatimore	25.5	25.2	25.3	26.5	27.2	27.3	27.3	27.4
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.1	18.2	17.8	18.4	19.1	19.3	19.5	19.6
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.4	1.3	1.3	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	5.9	5.7	6.1	6.5	6.5	6.4	6.3	6.2
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.2	1.0	1.0	1.7	1.0	1.0	0.9	0.9
	TOTALI I SHPENZIMEVE	31.9	30.3	28.5	30.1	31.5	30.8	30.8	30.1
I.	Shpenzime Korrente	24.7	23.3	23.1	24.8	25.0	24.7	24.5	24.2
I.1	Personeli	4.5	3.9	4.2	4.6	4.9	4.8	4.8	4.7
	Paqja	3.8	3.4	3.6	3.9	4.2	4.0	3.8	3.6
	Kontributi për sigurim e shoqërore	0.6	0.5	0.6	0.6	0.7	0.7	0.6	0.6
	Fondi i veçantë i paqave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Politika të reja paqash	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1
	Indeksimi i paqave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.3
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.2	Interesat	1.9	1.8	2.0	2.2	2.6	2.5	2.5	2.4
	Të brendshme	1.3	1.1	1.2	1.3	1.4	1.4	1.4	1.4
	Të huaja	0.7	0.7	0.8	0.9	0.9	0.9	0.8	0.8
	Kontingjencë për risqet e bonhit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	3.2	3.2	3.0	3.4	2.9	2.8	2.7	2.6
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Arsimi i lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Të tjera jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	10.7	10.1	9.6	10.1	10.1	10.0	10.1	10.0
	Sigurim e shoqërore	7.9	7.6	7.2	7.5	7.3	7.4	7.4	7.3
	Politika të reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Bonusi i pensionistit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Sigurim e shëndetësore	2.6	2.4	2.3	2.4	2.4	2.3	2.2	2.1
	Shpenzim e për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1	0.2	0.2
I.6	Buxheti lokal	2.8	2.7	2.9	3.3	3.4	3.4	3.4	3.4
	Transferat nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	1.4	1.4	1.4	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6
	Transferat e pakushtëzuar e përqijthshme	0.0	0.0	0.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
	Transferat e pakushtëzuar sektorale (Grant Specifici)	0.0	0.0	0.0	0.4	0.5	0.6	0.6	0.6
	Transferat sektorale për paqat, etj.	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Buxheti lokal në ardhurat e veta (jo-tatimore)	1.4	1.3	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6	1.6
	Taksa të ndara	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Buxheti lokal në ardhurat e veta (jo-tatimore)	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0
I.7	Transferat të tjera	1.6	1.4	1.3	1.1	1.1	1.0	1.0	1.0
	Paqesa e paqunësishë	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndihma ekonomike dhe politike e femijëve, etj.	1.3	1.2	1.1	1.0	0.9	0.9	0.8	0.8
	Kompensim për të përndjekurit politikë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Bonusi i lindjeve	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	0.1	0.3	0.3
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.2	0.2
	Rezerve për zjedhjet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	Kontingjencë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1
	Fondi rezervë për reformat/masat e New Growth Plan	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
III.	Shpenzime kapitale	6.9	5.2	5.0	5.1	6.2	6.1	6.1	5.6
	Financimi i brendshëm	3.9	3.0	3.7	3.7	4.3	4.1	3.4	3.2
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Financimi i huaj, nga të cilat:	1.4	0.9	0.6	1.0	1.7	1.8	2.6	2.2
	në sektorin e energjisë	0.1	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	prej New Growth Plan	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.9	0.4
	Trans kapitale për lloq, speciale të shpronësimeve	1.6	1.3	0.7	0.4	0.2	0.2	0.1	0.2
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit	1.6	1.3	0.7	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)	0.2	1.3	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
V.	Të tjera	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
	Hua e dhene për sis. energj. e të tjera nga burimet e brendshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9
VI.	Fondi shpronësimit	0.2	0.5	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
VII.	Transferat për Lloqarinë e Fondit të Pensioneve në BSH	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	DEFICITI	-4.6	-3.6	-1.3	-1.5	-2.6	-1.9	-1.6	-1.0
	FINANCIMI DEFICITIT	4.6	3.6	1.3	1.5	2.6	1.9	1.6	1.0
I.	I brendshëm	-1.0	4.1	-0.3	2.1	2.3	1.7	0.9	0.7
	Të ardhura nga privatizimi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Hua-marrje e brendshme (neto)	2.6	1.2	0.9	2.0	1.9	1.6	1.0	0.8
	Të tjera, nga të cilat:	-3.6	2.9	-1.2	0.1	0.4	0.1	-0.1	-0.2
	Ndërshimi i qendjes së likuiditetit në TSA	-3.9	1.9	-1.7	-0.3	0.4	0.1	-0.1	-0.2
	Ndërshimi i qendjes së depozitës siq. Shoaq Shend	0.0	0.0	0.0	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	I huaj	5.6	-0.4	1.6	-0.6	0.3	0.2	0.6	0.3
	Hua afatgjatë (e marrë)	5.0	0.5	3.1	0.6	3.3	1.1	3.7	3.5
	Per projekte, nga të cilat:	0.8	0.5	0.4	0.6	1.0	1.1	1.6	1.4
	prej New Growth Plan	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.4	0.2
	Eurobond	4.2	0.0	2.6	0.0	2.3	0.0	2.1	2.0
	Nën-hua (Pushteti vendor)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndërshimi i qendjes së arkës	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ripaquesat	-1.8	-1.8	-2.2	-1.7	-3.8	-1.3	-3.4	-3.1
	Eurobond	0.0	0.0	-0.6	0.0	-1.4	0.0	-2.3	-2.0
	Maturim	0.0	0.0	0.0	0.0	-1.4	0.0	-2.3	-2.0
	Para-bletje	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	2.3	0.8	0.8	0.4	0.8	0.4	0.3	0.3
MEMO:									
	Balanca e përqijthshme (defiditi përqijthshëm)	-4.6	-3.6	-1.3	-1.5	-2.6	-1.9	-1.6	-1.0
	Balanca korente	2.3	1.6	3.7	3.6	3.6	4.2	4.5	4.6
	Balanca primare	-2.7	-1.8	0.7	0.7	0.0	0.7	0.9	1.4
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	3.9	0.7	2.0	2.2	1.7	1.6	1.6	1.7
	Borxhi publik NETO nga qendja e likuiditetit në TSA (stok)	70.2	63.5	55.5	53.0	53.1	52.5	51.5	50.4
	Borxhi publik BRUTO (stok)	74.1	64.1	57.5	55.2	54.8	54.0	53.2	52.1
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	71.1	61.7	55.8	53.7	53.3	52.5	51.6	50.3
	I brendshëm (stok)	36.4	33.2	30.6	31.1	31.5	31.6	31.1	30.4
	I huaj (stok)	34.8	28.5	25.1	22.7	21.9	20.9	20.6	19.9
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	3.0	2.4	1.7	1.5	1.4	1.5	1.5	1.7
	Pushteti vendor (stok)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Borxhi publik i qantuar (stok)	2.9	2.4	1.7	1.4	1.4	1.5	1.5	1.7
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave



UDHËZIM

Nr. 4, datë 4.2.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM
NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN
MBI TË ARDHURAT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin e përgjithshëm të ministrit të Financave nr. 26, datë 8.9.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 3.4, shtohen pikat 3.5, 3.6, 3.7, 3.8, me përmbajtje si më poshtë:

“3.5 Termi “honorar” lidhet me të drejtat ose pronën që përbëjnë format e ndryshme të pronësisë letrare dhe artistike, elementet e pronësisë intelektuale dhe informacionet në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore, patentat, licencat, shpikjet, markat tregtare etj.

Ky term zbatohet për pagesat për përdorimin ose të drejtën për të përdorur, të drejtat e llojit të përmendura më sipër dhe i referohet ekzistencës së një aktivi jomaterial, i cili, në përgjithësi, është i regjistruar në pasqyrat financiare në rastin e një entiteti, është i regjistruar në një regjistër të posaçëm sipas legjislacionit në fuqi të fushës përkatëse, në rastin e një personi fizik, ose në raste të veçanta mund të mos jetë i regjistruar.

Në këtë kuptim, në fushën e biznesit dhe të drejtave të autorit honorari përfshin një shpërblim ose pagesë që një person, fizik apo juridik, merr për përdorimin nga të tretët të një prone intelektuale ose të së drejtës së autorit që i përket këtij personi fizik apo juridik.

Kur pagesat bëhen për tjetërsimin e plotë të pronësisë të çdo elementi të përmendur në përkufizimin e termit “honorar”, atëherë nuk kemi të bëjmë me të drejta përdorimi dhe për rrjedhojë ato nuk mund të konsiderohen honorar.

Sipas përkufizimit në nenin 3, pika 21 të ligjit, “honorarë” janë pagesat për përdorimin ose të

drejtën e përdorimit të një aktivi jomaterial dhe përfshijnë sa më poshtë:

a) Përdorimin ose të drejtën për të përdorur një të drejtë autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat ose regjistrimet video ose audio, pavarësisht nëse vepra është në format elektronik ose ndryshe.

Parimi kryesor në klasifikimin si pagesa për të drejtën e autorit është që personi blerës i së drejtës gëzon të drejtën e botimit, publikimit, shumëfishimit, pra gëzon të drejtën e përdorimit për qëllime të biznesit të tij të një veprë, filmi, regjistrimi etj., të cilat përdoren nga blerësi për biznes.

Shembull. Një shkrimtar shkruan një libër artistik dhe i jep shtëpisë botuese “T” të drejtën e botimit dhe shpërndarjes së librit. Pagesat që shtëpia botuese “T” i bën shkrimtarit për këtë të drejtë konsiderohen “honorarë” dhe për to duhet të mbahet tatimi në burim. Pagesat që shtëpia botuese “T” merr nga libraritë për librat që u ka shitur apo nga klientët nëse i shet vetë librat, janë të ardhura biznesi për shtëpinë botuese dhe për to nuk mbahet tatim në burim.

b) Përdorimin ose të drejtën për të përdorur një patentë, licencë, shpikje, markë tregtare, dizajn ose model, plan, formulë ose proces sekret, ose pronë apo të drejtë tjetër të ngjashme.

Edhe në këto raste që lidhen me përvojën industriale, tregtare ose shkencore, produkt i të cilave janë patentat, licencat, shpikjet, markat e regjistruara etj., sa më lart, parimi kryesor që një pagesë të kategorizohet si pagesë honorari lidhet me përdorimin ose të drejtën e dhënë për të përdorur këto lloj asetesh të paprekshme.

Shembull. Një laborator studimor zbulon formulën e prodhimit të një vaksine. Laboratori e regjistron këtë të drejtë autori (patentë) në emrin e tij dhe autorizon një kompani prodhimi farmaceutik për ta prodhuar dhe shpërndarë vaksinën. Në këtë rast, pagesat që kompania e prodhimit farmaceutik i bën laboratorit studimor konsiderohen “honorarë” dhe për to duhet të mbahet tatimi në burim. P.sh. Kompania farmaceutike prodhon dhe shet 1 milion vaksina dhe i paguan honorar laboratorit, p.sh. 5 euro për çdo vaksinë të shitur. Kjo pagesë karakterizohet si honorar.

Pra, pagesa që përdoruesi i bën pronarit të patentës, markës tregtare etj., sipas kontratës,



është honorar dhe jo blerja e mallit apo shërbimit nga konsumatori final, qoftë ky konsumator individ apo biznes.

Në fushën e teknologjisë së informacionit, termi “honorar” përdoret për të përshkruar një pagesë që një person, kompani apo organizatë merr për dhënien e së drejtës së përdorimit të një teknologjie *software*.

Një lloj tjetër transaksioni, që përfshin transferimin e *software*-it kompjuterik, është rasti kur një shtëpi *software*-sh ose programues kompjuteri, pranon të japë informacion rreth ideve dhe parimeve, që qëndrojnë në themel të programit, të tilla si: logjika, algoritmet, gjuhët ose teknikat e programimit.

Marrëveshjet ndërmjet një mbajtësi të së drejtës së autorit të *software*-it dhe një ndërmjetësi të shpërndarjes shpesh i japin ndërmjetësit të shpërndarjes të drejtën për të shpërndarë kopje të *software*-it në media ose në mënyrë elektronike, pa të drejtën për ta riprodhuar atë *software*. Në transaksione të tilla, shpërndarësit paguajnë vetëm për blerjen e kopjeve të *software*-it dhe jo për të shfrytëzuar të drejtat e autorit të *software*-it, dhe për rrjedhojë pagesat në këto lloj transaksionesh do të duhet të trajtohen si fitime nga biznesi dhe jo si honorarë.

Pagesat për *software*-ët mund të bëhen edhe sipas kontratave të përziera. Shembuj të kontratave të tilla përfshijnë shitjet e pajisjeve kompjuterike me *software* (programe) të integruar, si dhe dhënia e së drejtës për të përdorur *software* (programe) të kombinuar me ofrimin e shërbimeve. Mënyra e përshtatshme për të vepruar me një kontratë të përzier është, në parim, që shuma totale që duhet të paguhet sipas një kontrate, të zbërthehet në bazë të informacionit të përfshirë në kontratë dhe të paguhet tatimi bazuar në specifikën e secilës pjesë të kontratës së përzier;

c) Marrjen ose të drejtën për të marrë çdo imazh ose tingull vizual ose të dyja të transmetuara me satelit, kablo, fibër optike ose teknologji të ngjashme në lidhje me transmetimin televiziv, radio ose në internet.

Në fushën e transmetimeve televizive, “honorari” është një shpërblim ose pagesë që një person, kompani ose pronar i të drejtave përfiton për përdorimin e një programi televiziv, filmi apo përmbajtjes së ngjashme. Kjo pagesë mund të përfshijë të ardhura nga transmetimet televizive

transmetime në rrjetet kablore ose satelitore, platformat *streaming* ose licencat e tjera të përdorimit të përmbajtjes. Është një mekanizëm që pronarët e të drejtave të autorit dhe krijuesit të përfitojnë nga përdorimi i përmbajtjes së tyre nga media. Shuma e pagesës së honorarit mund të përcaktohen nga marrëveshjet kontraktuale dhe standardet e industrisë.

ç) Përdorimin ose të drejtën për të përdorur informacione në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

Klasifikimi i pagesave të honorarëve të marra për informacionin në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore, lidhet kryesisht me konceptin e njohurive (“know-how”). Fjalët “pagesa për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore” përdoren në kontekstin e transferimit të një informacioni të caktuar që nuk është patentuar dhe që përgjithësisht nuk bën pjesë në kategori të tjera të të drejtave të pronësisë intelektuale. Në përgjithësi korrespondon me një informacion të pazbuluar të një natyre industriale, tregtare ose shkencore që rrjedh nga përvoja e mëparshme, e cila ka zbatim praktik në funksionimin e një ndërmarrjeje dhe nga zbulimi i të cilave mund të nxirret një përfitim ekonomik.

E rëndësishme është që të identifikohen drejt situatat e kontratave dhe transaksioneve për të dalluar se kur kemi të bëjmë me pagesë “honorari”, për të cilën duhet të mbahet tatim në burim dhe kur kemi të bëjmë me pagesa faturash për blerje shërbimi apo aktiveve të tjera të patrupëzuara, për të cilat nuk mbahet tatim në burim nga paguesi i faturës.

Në rastin e kontratave për ofrimin e shërbimeve, kur furnizuesi merr përsipër të kryejë shërbime të cilat edhe mund të kërkojnë përdorimin nga ai furnizues të njohurive, aftësive dhe ekspertizës së veçantë, por nuk kërkojnë transferimin e njohurive, aftësive ose ekspertizës së tillë të veçantë te tjetri, nuk ka kalim të së drejtës së autorit. Një kontratë për kryerjen e shërbimeve, në shumicën e rasteve, përfshin një nivel shumë më të madh shpenzimesh nga furnizuesi për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale.

Për rastet kur ka marrëveshje bilaterale për shmangien e tatimit të dyfishtë, referencë kryesore për trajtimin e honorarëve do të jenë dispozitat e marrëveshjes, si dhe Komentarët përkatës të



model marrëveshjeve të OECD-së dhe UN. Në çdo rast duhet të analizohet me kujdes nëse kemi të bëjmë me pagesa për të drejta autori apo pagesa të zakonshme biznesi për blerje mallrash apo shërbimesh.

Për këtë qëllim, tatimpaguesit duhet të analizojnë me kujdes termit e kontratës dhe natyrën e transaksionit ndërmjet palëve për të identifikuar natyrën e pagesave dhe të bëjnë ndarjen e tyre në faturat e gjeneruara. Administrata tatimore mund të kërkojë informacione shtesë për ndarjen midis pagesës për licenca *software*-ike, tarifës së shërbimit apo blerjes së pajisjeve kompjuterike në rastet kur vlera e pagesës për licenca *software*-ike është anomalisht e ulët krahasuar me pagesat për shërbime.

3.6 Dividend për njësi (aksion/kuotë pjesëmarrjeje në kapital) është shuma e dividendit që përfitohet për çdo njësi aksioni/kuotë pjesëmarrjeje individual/e të një kompanie.

3.7 Dividendi i ndërmjetëm është shpërndarja e fitimeve për aksionarët përpara fundit të vitit fiskal bazuar në pasqyrat financiare paraprake. Dividendë të tillë janë në shumën më të vogla se dividendi vjetor dhe paguhen nga fitimi i vitit bazuar në pasqyrat financiare paraprake dhe diferenca e vlerës së dividendëve kryhet me mbylljen e vitit fiskal dhe mbylljen përfundimtare të pasqyrave financiare.”

2. Në pikën 5.5, fjalë e dytë me përmbajtje “Nëse në marrëveshje nuk ka klauzola në lidhje me ndarjen e së drejtës të taksimit të ndonjë

kategorie të ardhurash, zbatohet parimi i përgjithshëm i taksimit të një jorezidenti duke mbajtur tatimin në burim.”, hiqet.

3. Pika 12.8 ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“12.8 Nëse një i vetëpunësuar, 80 % të të ardhurave të fituara i siguron nga 1 klient i vetëm, apo 90 % të të ardhurave të fituara nga më pak se 3 klientë, për qëllime të llogaritjes së detyrimit tatimor mbi të ardhurat neto vjetore të tij (të ardhura të faturuara minus shpenzimet e zbritshme të biznesit), do të aplikohen normat e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (pas zbritjes së shumave sipas neneve 22 dhe 23 të ligjit). Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, individ i vetëpunësuar llogarit nëse e ardhura plotëson kriteret e parashikuara në germen “ç”, të pikës 1, të nenit 12 dhe, nëse këto të ardhura rezultojnë sipas këtyre kushteve, deklarimi i të ardhurave sipas këtij paragrafi, do të bëhet nga vetë i vetëpunësuar në deklaratën tatimore vjetore të tij. Individ i vetëpunësuar në deklaratën vjetore të biznesit do t’i deklarojë të ardhurat duke plotësuar rubrikën e të ardhurave nga punësimi dhe nuk plotëson rubrikën e të ardhurave nga biznesi.

Rregulli sipas këtij paragrafi zbatohet dhe nëse i vetëpunësuar ka marrë ndonjë pagesë edhe nga ndonjë klient jorezident tatimor shqiptar.

Ky paragraf zbatohet pavarësisht nëse i vetëpunësuar ofron shërbime i vetëm apo ka edhe punonjës të papaguar të familjes, apo ka edhe të punësuar.

Shembull.

Deklarimi për vitin 2025 - Individ i vetëpunësuar me inicialet “A.B.” me kod ekonomik J6201 “Aktivitete të programimit informatik”, rezultojnë se gjatë vitit 2025, ka pasur të ardhura bruto nga biznesi në shumën 4,000,000 lekë. Nga këto të ardhura, 3,280,000 lekë të totalit të të ardhurave i ka realizuar nga kompania me inicialet “C.D.”, ndërkohë që pjesa tjetër e të ardhurave tatimore prej 720,000 lekë rezultojnë nga 5 kompani të tjera. Shpenzimet tatimore të individit të vetëpunësuar për vitin 2025 janë 1,000,000 lekë.

Shënime të tjera: Ndërkohë individ i vetëpunësuar ka një fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe ka të ardhurat vjetore më të larta të tatueshme në familje.

<i>Si do të tatohen të ardhurat e individit të vetëpunësuar:</i>	82% (3,280,000 lekë/4,000,000 lekë) e të ardhurave nga biznesi rezultojnë nga 1 klient i vetëm. Duke qenë se të ardhurat e individit të vetëpunësuar janë 80% e më shumë nga 1 klient i vetëm (shkronja ç/i, pika 1, e nenit 12) atëherë fitimi i tatueshëm i individit të vetëpunësuar do të konsiderohet e ardhura nga punësimi për llogaritje të detyrimit tatimor. <i>Shënim. Vetëm për qëllim të llogaritjes së masës në % të së ardhurës së fituar nga secili klient, pesha për të ardhurën e fituar nga klienti konsiderohet e njëjtë me peshën e së ardhurës bruto nga klienti.</i>
<i>Si do të bëhet deklarimi:</i>	Individi i vetëpunësuar në deklaratën e tij vjetore “Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi” do të plotësojë rubrikat 8/9 “Të ardhura nga punësimi”.



	<i>Pasi plotëson rubrikat 8 dhe 9, rubrikat nga 10 deri në rubrikën 21, që i përkasin të ardhurave nga biznesi nuk plotësohen.</i>
<i>Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi:</i>	<i>Baza e tatueshme = Të ardhura tatimore – (zbritjet tatimore + shpenzimet tatimore)</i> <i>*Shënim. Individ i vetëpunësuar, duke qenë se ka të ardhura vjetore deri në 10,000,000 lekë, ka të drejtë të zgjedhë regjimin e veçantë për njohjen e shpenzimeve të zbritshme. Ky shpenzim i zbritshëm apriori është 30% për individët e vetëpunësuar. Në rubrikën 28 të deklaratos, konkretisht ky subjekt zgjedh kutizën “Po” për zbritjen apriori të shpenzimeve.</i> <i>- Në shembullin e paraqitur, duke qenë se individ i zgjedh zbritjen apriori të shpenzimeve, shpenzimet e zbritshme do të jenë:</i> <i>$30\% \times 4,000,000 \text{ lekë} = 1,200,000 \text{ lekë}$</i> <i>- Ndërkohë tatimpaguesi përfiton dhe zbritjet sipas nenit 22, pika 1 e ligjit, konkretisht 360,000 lekë sipas shkronjës “c” dhe 1*48,000 lekë sipas shkronjës “ç”.</i> <i>Baza e tatueshme = 4,000,000 lekë – (360,000 lekë + 48,000 lekë + 1,200,000) lekë</i> <i>Baza e tatueshme = 2,392,000 lekë</i> <i>Tatimi i llogaritur = 13%*2,040,000 lekë + 23%*352,000 lekë</i> <i>Tatimi i llogaritur = 346,160 lekë</i>

Referuar pikës “e”, të nenit 69 të ligjit, për të gjithë tatimpaguesit të regjistruar para datës 31 dhjetor 2023, të cilët janë subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin apo tatimit mbi fitimin, si edhe për ata që regjistrohen për herë të parë në vitin pasardhës, për efekt të periudhës tatimore 2024, do të përdoren formularët dhe përgjegjësitë tatimore, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Për rrjedhojë, përllogaritja, detyrimi dhe deklarimi do të fillojnë nga data 1 janar 2025.”

4. Në pikën 12.11, shembulli ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Shembull.

Një kompani ndërtimi shqiptare ka kërkuar nga një agjenci punësimi kineze që ta furnizojë me 50 punonjës ndërtimi, të cilët do të punojnë për një periudhë 6-mujore. Pagesa totale, e cila përfshin koston e punës dhe komisionin e agjencisë është 380.000 euro.

Për nevoja të zbatimit të paragrafit 3, të nenit 12 të ligjit, fondi i pagave bruto supozohet të jetë $380.000 \text{ euro} \times 80\% = 304.000 \text{ euro}$. Secili punonjës supozohet të ketë përfituar mesatarisht: $304.000 \text{ euro} : 6 \text{ muaj} : 50 \text{ punonjës} = 1.013 \text{ euro në muaj}$. Kjo do të jetë baza mbi të cilën do të llogaritet detyrimi tatimor për çdo punonjës, ndërkohë që detyrimin për deklarimin dhe pagesën e tatimit e ka kompania shqiptare e ndërtimit.

Ndërsa diferenca prej 76 mijë euro (20% e 380 mijë euro), bazuar në këtë shembull, do të jetë e ardhur biznesore për agjencinë kineze të punësimit, prandaj për këtë shumë nuk do të mbahet tatim pasi

bazuar në marrëveshjen që kemi nënshkruar me qeverinë e Republikës Popullore të Kinës “Për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, për aq kohë sa agjencia kineze nuk ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë, fitimet e saj biznesore do të tatohen vetëm në Kinë.

Shënim. Vlerësimi sesi do të tatohet e ardhura e agjencisë së huaj të punësimit dhe a do të mbahet tatim në burim, do të bëhet rast pas rasti bazuar në kontratën dhe dispozitat e ligjit dhe marrëveshjeve në fuqi.”

5. Në pikën 14.1, në shkronjën “b”, fjalia e parë ndryshon me këtë përmbajtje:

“Me dëshirën e tij, personi fizik, individ tregtar apo individ i vetëpunësuar, i cili ka realizuar qarkullim vjetor deri në 10.000.000 lekë për vitin tatimor, për qëllime të njohjes së shpenzimeve të zbritshme mund të zgjedhë të zbatojë formën e zbritjes apriori të shpenzimeve sipas nenit 14 të ligjit, duke pasqyruar si shpenzime, të cilat zbriten nga e ardhura, shumën e supozuar në % të qarkullimit (të ardhurës bruto) sipas paragrafit 1, të nenit 14 për çdo kategori biznesi.”

6. Pika 17.2 hiqet nga përmbajtja e këtij udhëzimi.

7. Pas pikës 27.5, shtohet pika 27.6 me këtë përmbajtje:

“27.6 Entitetet e përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës, sipas paragrafit 2, të nenit 27 të ligjit, të cilat nuk detyrohen të dorëzojnë në organet tatimore deklaraten tatimore dhe pasqyrat e raportimit financiar, janë:



a) organet e pushtetit ekzekutiv përfshirë organet e pushtetit qendror dhe vendor, organet e pushtetit legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore;

b) Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.”.

8. Në pikën 50.1, në shkronjën “v”, në nënparagrafin “ii” dhe në shembullin ilustrues të kësaj shkronje, pas togfjalëshit: “...pjesë të federatave sportive...”, shtohet togfjalëshi: “..., si dhe ekipet kombëtare të organizuara nga federatat shqiptare...”.

9. Në pikën 56.1, në shkronjat “a” dhe “c”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në shkronjën “c”, togfjalëshi “...Deklarata e tatimit të mbajtur në burim...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... Deklarata e tatimit të mbajtur në burim dhe të ardhurat e tjera...”;

b) Shkronja “e” ndryshohet me përmbajtjen:

“e. Në rastet kur norma tatimore e aplikuar për tatimin e mbajtur në burim është e ndryshme nga normat standarde të parashikuara në ligjin e tatimit mbi të ardhurat, agjenti i mbajtjes së tatimit në burim ka detyrimin për të kërkuar dhe ruajtur Certifikatën e Rezidencës së përfituesit të të ardhurave, si dokument mbështetës për saktësinë e deklaratës tatimore të tatimit të mbajtur në burim.”.

10. Në nënpikën 58.4.1, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me përmbajtje si më poshtë:

“c. Në rastin kur personat fizikë ushtrojnë aktivitet fitimprurës (të regjistruar si të vetëpunësuar me apo pa punëmarrës) në ambientet në pronësi të individit personit fizik, nuk do të jenë objekt vlerësimi për tatimin e qirasë, pasi personi fizik dhe individ pronar i pasurisë së paluajtshme kanë të njëjtin status. Gjithashtu, nuk do të konsiderohet qiradhënie edhe në rast të ushtrimit të aktivitetit nga personi fizik i vetëpunësuar në ambientin e një personi të lidhur të familjes, me kushtin që të jetë pjesëtar në të njëjtën certifikatë familjare.”.

11. Në pikën 58.6, në shkronjat “a” dhe “c”, bëhen shtesat si më poshtë:

a) Në fund të shkronjës “a”, shtohet teksti me këtë përmbajtje:

“Përfashtimin nga tatimi mbi të ardhurat, entitetet, sipas pikës 3, shkronja “a”, e nenit 58 të ligjit, e provojnë me dokumentacion të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore në të cilën janë regjistruar.”;

b) Në germën “c”, nënparagrafi “ii”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për qëllime të këtij paragrafi konsiderohen institucione financiare, institucionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të kryer veprimtari monetare dhe/ose me instrumentet financiare dhe të shpallura publikisht në faqet zyrtare të këtyre institucioneve si më poshtë:

a) Banka e Shqipërisë “Subjektet e licencuara” Subjekte të licencuara (bankofalbania.org); dhe

b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare AMF: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare “Regjistri i të licencuarave”/Tregu i titujve/Tregu i Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive/Tregu i Fondeve të Pensioneve Vullnetare/Tregu i Sigurimeve.”

12. Në fund të pikës 61 “Deklarata tatimore vjetore”, shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:

“Bazuar në Standardin 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike”, mikronjësitet ekonomike që realizojnë qarkullim më pak se 5 milionë lekë, nuk kanë detyrim për të mbajtur dhe raportuar pasqyrat financiare por mbajnë dokumentacion të thjeshtuar të aktivitetit të tyre tregtar, sipas afatit të parashikuar në Standardin 15.”.

13. Në pikën 63.2.3, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia me përmbajtje si vijon:

“Vlerësimi nëse këta tatimpagues kanë ose jo detyrimin për t’u përllogaritur dhe paguar këstet, do të bëhet me metodën proporcionale të përllogaritjes së qarkullimit vjetor.”.

14. Aneksat 2, 3, 4 dhe 5 bashkëlidhur udhëzimit, zëvendësohen me anekset 2, 3, 4 dhe 5 bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj



ANEKS NR. 2

LISTËPAGE SA E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT NG A PUNËSIMI

DEKLARATA "Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi"

1) NIPIT: _____; 2) Emri i Tatimpaguesit

3) Periudha Tatimore: _____ Muaji: _____

4) Periodiciteti i deklarimit _____ Adresa kryesore _____

5) Veprimtaria Kryesore: _____

6) Veprimtaria e degës vijnë së: _____

7) Veprimtaria e degës vijnë së: _____

8) ☐ PA Veprimtari

Kontributet për sigurimet shoqërore në këtë

16) Paga bruto mbi të cilën llogariten kontribute të sigurimit shoqërore të detyrueshme

17) Pundhësi

18) Pundhësi

19) Gjithësi (17+18)

20) Pundhësi

21) Pundhësi

22) Gjithësi (20+21)

23) Totali i Kontributeve për sigurimet shoqërore (19+22)

24) Paga bruto mbi të cilën llogariten kontribute të sigurimit shoqërore

25) Kontribute për sigurimet shëndetësore

26) Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhësi në fondet e pensioneve vullnetare si kontribut i punëdhënësit

27) Zbritja tatimore që përfiton punonjësi sipas art. 29/2013

28) Kaza tatimore mbi të cilën llogaritet TAP (15-26)

29) Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi (TAP) gjithësi në leke

30) Deklarata e statust personal

31) Shënim

Totali i Listëpagesës

Deklaroj se të dhënat e kësaj Listëpagese përmbajnë:

32) Punonjësi që duhet të paguajnë kontribute ☐ person ☐ le

33) Shuma totale e detyrimit për kontributet dhe TAP për ☐ le

34) Përfatësuesi i Personit Juridik (A dministratori/A dministratorët) (emër mbanë)

34) Deklaruesi (A dministratori ose Personi i autorizuar për deklarimin) / Personi Fizik (I autorizuan) (emër mbanë dhe nëshkrimi elektronik)

Faqe | 3121



UDHËZUESI I PLOTËSIMIT TË
LISTËPAGESËS SË KONTRIBUTEVE TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE,
SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË
ARDHURAT NGA PUNËSIMI

Të gjithë entitetet dhe personat fizikë (individë tregtarë apo individë të vetëpunësuar) me dhe pa punëmarrës, si dhe çdo person tjetër i cili ka detyrimin të plotësojë këtë deklaratë duhet të mbajnë parasysh sa më poshtë:

Punëdhënësi është **“Agjent tatimor i listëpagesës”**, në lidhje me detyrimin tatimor të të punësuarve, detyrim i cili lidhet me të ardhurat nga punësimi i tyre. Punëdhënësi në rolin e **“Agjentit tatimor të listëpagesës”** ka detyrimet e parashikuara në nenin 65 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Brenda datës 20 të muajit pasardhës, krahas pagesës së detyrimit, punëdhënësi njëkohësisht dorëzon çdo muaj listëpagesën ku janë të pasqyruara të gjitha elementet e pagës bruto, zbritjet e bazës tatimore për llogaritjen e kontributeve, bazës tatimore për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe pagën neto të përfituar nga punëmarrësi.

Punëdhënësi, në rolin e **“Agjentit tatimor të listëpagesës”**, mban tatimin mbi të ardhurat nga punësimi sipas parashikimeve të nenit 24 “Normat tatimore” të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Zbritja nga baza e tatimit (nga paga bruto) e parashikuar në paragrafin 1, të nenit 22 “Zbritjet nga baza tatimore” të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” lejohet të bëhet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi tatimpagues i tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, ka nënshkruar deklaratën mbi statusin personal me këtë punëdhënësi, sipas nenit 66 “Deklarata mbi statusin personal” të këtij ligji.

Deklarata ka një numër serial i cili gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të përditësuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.

Për plotësimin e rubrikave të deklaratës “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”, tatimpaguesit duhet të mbajnë parasysh sa më poshtë:

1. *Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT)* – është numri i dhënë nga QKB-ja dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve.

2. *Emri i tatimpaguesit* – është emri i subjektit i cili plotëson deklaratën në rolin e agentit tatimor të listëpagesës.

3. *Periudha Tatimore* – **viti**: shënohet viti; dhe **muaji**: shënohet muaji për të cilin bëhet deklarimi. Për çdo muaj kalendarik duhet të deklarohet një listëpagesë.

4. *Periodiciteti i deklarimit* – shënohet shpeshtësia apo periodiciteti i deklarimit. Personat fizikë, individë tregtarë apo individë të vetëpunësuar, që nuk janë të regjistruar për TVSH-në, shënojnë fjalën “tremujor”. Të gjithë entitetet, si dhe individët e vetëpunësuar apo individët tregtar të regjistruar për TVSH-në shënojnë fjalën “muajor”.

5. *Adresa* – tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT-it.

6. *Veprimtaria kryesore* – veprimtaria kryesore e tatimpaguesit.

7. *Veprimtaria e degës/njesisë* – veprimtaria ekonomike e degës/njesisë së tatimpaguesit, në rast se ka një degë, filial apo njësi.

8. *Pa veprimtari* – shënohet X për ato periudha tatimore kur tatimpaguesi nuk kryen veprimtari. Në këto raste nëpërmjet “Deklaratës së të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna” më përpara duhet të jetë deklaruar largimi nga puna i të gjithë punonjësve, përjashtuar administratorin e entitetit dhe personin fizik për veten e vet, për të cilët deklarohen të dhënat duke plotësuar rubrikat përkatëse me zero. Të gjithë entitetet dhe personat fizikë, të cilët kanë kaluar në regjistrin pasiv të tatimpaguesve në zbatim të pikës 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk llogariten dhe paguhen detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Në rubrikën “Shënime” të listëpagesës jepen shpjegimet për arsyet e mosdeklarimit të detyrimeve për kontributet.

9. *Numri personal* – plotësohet numri personal i të punësuarit.

10. *Emri dhe mbiemri* – plotësohet emri dhe mbiemri i të punësuarit.

11. *Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi* – plotësohet për funksionin apo detyrën e punëmarrësit.

12. *Numri i kategorisë së punonjësit për kontribute* – shënohet numri i kategorisë së punonjësve duke



zgjedhur një nga kategoritë e punonjësve për efekt të deklarimit dhe llogaritjes së kontributeve së cilës i përket punonjësi përkatës, si vijon:

Kategoria 1. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më shumë se 87 orë në muaj.

Kategoria 2. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më pak se 87 orë në muaj.

Kategoria 3. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri në 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më shumë se 87 orë në muaj.

Kategoria 4. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri në 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më pak se 87 orë në muaj.

Kategoria 5. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka punuar, më pas ka qenë me raport paaftësie të përkohshme deri në 14 ditët e para me raport dhe më tej nga dita e 15 vazhdon me raport mjekësor deri në fund të muajit dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri në 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës).

Kategoria 6. I punësuar për herë të parë apo rishtazi te subjekti përkatës pavarësisht nga data e fillimit dhe orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 7. I punësuar i larguar nga puna (shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës) pavarësisht nga data e shkëputjes dhe orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 8. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shuma e pagave të të dy subjektet është më e vogël se paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

Kategoria 9. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shuma e pagave të të dy subjektet

është sa ose më e madhe se paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore dhe paga e realizuar tek njëri subjekt është më e madhe se paga e realizuar te subjekti tjetër.

Kategoria 10. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur paga vetëm te njëri subjekt është sa ose më e madhe se paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

Kategoria 11. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës), pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 12. Punonjës i papaguar i familjes së personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 13. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës) i regjistruar për herë të parë apo pas ndërprerjes së veprimtarisë.

Kategoria 14. I vetëpunësuar (person fizik, me ose pa punëmarrës) i çregjistruar nga organet tatimore apo që ndërpret veprimtarinë gjatë muajit.

Kategoria 15. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, i regjistruar për herë të parë apo rishtazi tek ky subjekt.

Kategoria 16. Punonjës i papaguar i familjes të personit fizik me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, i larguar nga puna gjatë muajit.

Kategoria 17. I vetëpunësuar dhe i punësuar në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) tek i cili paguan kontribute mbi pagë më të vogël se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

Kategoria 18. Punonjës i papaguar i familjes që punon në personin fizik të regjistruar në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon bashkëjeton ligjërisht, dhe gjithashtu është i punësuar edhe në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) tek i cili paguan kontribute mbi pagë më të vogël se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

Kategoria 19. I vetëpunësuar (person fizik) apo dhe punonjës i papaguar i familjes me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, i punësuar edhe në subjekt tjetër (person juridik ose person fizik) tek i cili paguan kontribute mbi pagë sa ose më të madhe se paga maksimale mbi të cilën llogariten kontributet shoqërore.

Kategoria 20. Ortak i vetëm i punësuar në personin juridik të regjistruar në emër të tij dhe, gjithashtu, i regjistruar edhe si person fizik (i vetëpunësuar).



Kategoria 21. I vetëpunësuar në dy subjekte persona fizikë të regjistruara në emër të tij.

Kategoria 22. I vetëpunësuar (person fizik), i cili punon edhe si punonjës i papaguar i familjes në një subjekt person fizik i regjistruar në emër të familjarëve të tij, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 23. Punonjës i papaguar i familjes që punon në dy subjekte persona fizikë dhe të regjistruara në emër të familjarëve të tij me të cilët ai punon, bashkëjeton ligjërisht, pavarësisht nga orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 24. I punësuar me kontratë me afat më pak se një javë gjatë vitit.

Kategoria 25. I punësuar për herë të parë apo rishtazi në këtë profesion që deklarohet, në subjekte, të cilat punojnë me material porositësi (fason), së bashku me kohën e punuar në të njëjtin profesion në subjekte fason, për afatin e caktuar sipas kuptimit të VKM-së përkatëse.

Kategoria 26. Person në periudhën e programit të nxitjes së punësimit të miratuar dhe me financim të pjesshëm nga zyra përkatëse e punësimit të totalit të detyrimit për kontributet.

Kategoria 27. Person në periudhën e kursit të formimit profesional, apo dhe programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë, të miratuara dhe me financim nga zyra përkatëse e punësimit të detyrimit të kontributeve vetëm për degën e aksidenteve në punë.

Kategoria 28. Nxënës i shkollës së mesme apo profesionale, apo student, për kohën e praktikës mësimore të miratuar nga institucionet përkatëse shtetërore.

Kategoria 29. I vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi, ambulant.

Kategoria 30. I punësuar si punëtor shtëpie nga kryefamiljari i regjistruar në organin tatimor.

Kategoria 31. I punësuar, i cili për të gjithë muajin ka qenë me raport leje barrëlindje dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës.

Kategoria 32. I punësuar, i cili për të gjithë muajin ka qenë me raport mjekësor pas ditës së 14 dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës.

Kategoria 33. I punësuar me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e

punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse, për të cilët lind detyrimi i derdhjes së kontributeve nga punëdhënësi, sipas dispozitave të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Kategoria 34. Person i papunë (grua) me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë lekë) në muaj.

Kategoria 35. Kujdestar i personit invalid paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

Kategoria 36. I vetëpunësuar i vetëm që është përfitues i pensionit të pleqërisë.

Kategoria 37. Person i trajtuar me pagesë kalimtare, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar.

Kategoria 38. Person i papunë që përfiton pagesë papunësie.

Kategoria 39. Nxënës që mëson profesionin, që ndjek arsimin dhe formimin profesional në kualifikimet e niveleve 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në formën e dyfishtë dhe që ka lidhur një kontratë pune për mësimin e profesionit.

13. Ditë kalendarike pa punuar gjatë muajit nga punonjësi (e drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore) – plotësohet numri i ditëve kalendarike të papunuara gjatë muajit nga punonjësi, për ato raste që ai duhet të marrë përfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqërore, p.sh. ditë me raport paaftësie të përkohshme (duke filluar nga dita e 15 e raportit), ditë me leje barrëlindje etj., përfitime sipas ligjit. Në qoftë se një punonjës për të gjithë muajin raportues ka qenë me raport (pas ditës së 14 të raportit), apo leje barrëlindje etj. përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore dhe personi nuk i ka shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me atë tatimpagues, emri i tij do të pasqyrohet në listëpagesë, do të shënohet numri i të gjitha ditëve të muajit, ndërsa në kolonat e tjera shënohet zero. Në qoftë se punonjësi nuk ka asnjë “Ditë kalendarike pa punuar gjatë muajit (e drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore)” në këtë rubrikë vendoset zero dhe nuk lihet bosh.

14. Ditë kalendarike të punuara gjatë muajit nga punonjësi – shënohet numri i ditëve kalendarike të muajit në të cilat punonjësi ka punuar tek



tatimpaguesi. Këto ditë të punuara duhet të jenë të rakorduara me deklaratimet e dorëzuara gjatë muajit në organin tatimor me deklaratën “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Këtu do të shënohen edhe ditët me raport deri në ditën e 14, për të cilat punëmarrësi paguhet nga tatimpaguesi sipas Kodit të Punës dhe për këto ditë i llogariten kontribute, si dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Në qoftë se punonjësi nuk ka asnjë “Ditë kalendarike të punuar te ky tatimpagues gjatë muajit” për arsye se i ka të gjitha ditët e muajit të plotësuar sipas rubrikës 13 me “Ditë kalendarike pa punuar gjatë muajit (e drejta për përfitime nga sigurimet shoqërore)” etj. në këtë rubrikë vendoset zero dhe nuk lihet bosh.

15. *Paga bruto e punonjësit* – shënohet paga bruto gjithsej nga punësimi, përfshirë të ardhurat në të holla ose në natyrë, që i është llogaritur punonjësit për muajin raportues.

16. *Paga bruto mbi të cilën llogariten kontributet për sigurimet shoqërore* – shënohet paga bruto mujore mbi të cilën llogariten kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe kontributi shtesë, brenda kufijve minimal e maksimal të pagës për efekt të llogaritjes së kontributeve të të punësuarve, sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë pagë përfshihet gjithashtu edhe shuma e lekëve që zbritet nga paga bruto gjithsej dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit. Personi fizik, për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes, shënon pagën minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve, e cila sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave është paga minimale në shkallë vendi. Personi fizik, për vete, me dëshirën e tij, në këtë rubrikë mund të vendosë një pagë edhe më të madhe nga paga minimale në shkallë vendi deri në kufirin e pagës maksimale për kontributet shoqërore të të punësuarve. Në pagën bruto mbi të cilën llogariten kontributet për sigurimet shoqërore përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarit për deri 14 ditët e para me raport mjekësor, për të cilat punëdhënësi i jep punëmarrësit në bazë të Kodit të Punës. Për efekte të zbatimit të kufirit minimal e maksimal të pagës, llogaritja dhe vlerësimi i detyrimit për kontributin e sigurimeve shoqërore për punonjësin, i cili gjatë muajit ka punuar në dy rrethe brenda të njëjtut subjekt (NIPT-i) bëhet mbi bazën e shumës së pagave të punonjësit në të dy rrethet.

17. *Punëdhënësi* – shënohet kontributi i sigurimeve shoqërore të detyrueshme për t’u paguar nga punëdhënësi sipas pagës mujore mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas VKM-së në fuqi. Personi fizik, për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes, në këtë rubrikë shënon të gjithë shumën e kontributit.

18. *Punëmarrësi* – shënohet kontributi i sigurimeve shoqërore të detyrueshme i mbajtur në burim nga punëdhënësi për punëmarrësin sipas pagës mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas VKM-së në fuqi. Personi fizik për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes në këtë rubrikë vendos zero.

19. *Gjithsej* – shënohet shuma totale e kontributit të sigurimeve shoqërore të detyrueshme për t’u paguar. Shuma e rubrikave 17 dhe 18. (17+18)

20. *Punëdhënësi* – shënohet kontributi shtesë p.sh. kontributet për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë për t’u paguar nga punëdhënësi sipas pagës mujore mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas ligjit në fuqi. Nga tatimpaguesit dhe për punonjësit që nuk duhet të paguajnë këtë kontribut kjo kolonë plotësohet me zero.

21. *Punëmarrësi* – shënohet kontributi shtesë p.sh.: për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë i mbajtur në burim nga punëdhënësi për punëmarrësin sipas pagës mbi të cilën llogariten kontributet, rubrika 16 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas ligjit në fuqi. Gjithashtu, në këtë rubrikë shënohet kontributi për sigurimin shoqëror suplementar, i detyrueshëm, që mbahet në burim nga punëdhënësi për punëmarrësin, për punonjësit e përcaktuar në ligjet dhe VKM-të përkatëse, në përqindjet e caktuara mbi pagën bruto gjithsej.

22. *Gjithsej* – shënohet shuma totale e rubrikave 20 dhe 21 për t’u paguar e kontributit shoqëror shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë dhe kontributit për sigurimin shoqëror suplementar për punonjësit e caktuar sipas ligjit përkatës në fuqi. Nga tatimpaguesit dhe për punonjësit që nuk duhet të paguajnë këtë kontribut kjo kolonë plotësohet me zero. (20+21)

23. *Totali i kontributeve për sigurimet shoqërore* – shënohet kontributi gjithsej i sigurimeve shoqërore për t’u paguar, përfshirë, kontributin shoqëror të detyrueshëm, kontributin shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë, si dhe kontributin



për sigurimin shoqëror suplementar, pra shuma e rubrikave 19 dhe 22, e cila është shuma që duhet të kalojë për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. (19+22)

24. *Paga bruto mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimit shëndetësore* – shënohet paga bruto mujore mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shëndetësore për personat e punësuar. Kjo pagë nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të të punësuarve (paga minimale në shkallë vendi) dhe nuk ka kufi të sipërm (tavan) të pagës bruto mujore. Personi fizik, për vete dhe për punonjësit e papaguar të familjes në këtë rubrikë shënon pagën minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimit shëndetësor, e cila është e barabartë me dyfishin e pagës minimale mujore mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore (pra dyfishin e pagës minimale në shkallë vendi), rubrika 16, sipas përcaktimit të VKM-së në fuqi. Në pagën bruto mbi të cilën llogariten kontributet për sigurimet shëndetësore përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarit për deri 14 ditët e para me raport mjekësor, për të cilat punëdhënësi i jep punëmarrësit në bazë të Kodit të Punës.

25. *Kontribute për sigurimet shëndetësore gjithsej* – shënohet kontributi i sigurimit shëndetësor për t'u paguar nga punëdhënësi sipas pagës mujore mbi të cilën llogariten kontributet rubrika 24 shumëzuar me përqindjen përkatëse sipas VKM-së në fuqi. Për personat, i vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi, ambulant, si dhe i punësuar si punëtor shtëpie në këtë rubrikë vendoset kuota fikse e kontributit sipas përcaktimit në VKM-së në fuqi.

26. *Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit* – zbritet nga të ardhurat personale të punësuarit për efekt tatimi. Kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, për efekte fiskale, nuk vlerësohen si të ardhura personale të anëtarit. Shuma që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondin e pensionit vullnetar nuk duhet të jetë më e madhe se paga minimale në shkallë vendi.

27. *Zbritja tatimore që përfiton punonjësi sipas germave “a”, “b” dhe “c”, të paragrafit 1, të nenit 22, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”* – punëdhënësi, në rolin e “Agjentit tatimor i listëpagesës”, mban tatimin nga paga

sipas parashikimeve të nenit 24 “*Normat tatimore*” të ligjit “*Për tatimin mbi të ardhurat*”.

Zbritja nga baza e tatimit (nga paga bruto) e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 22 “Zbritjet nga baza tatimore” të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, do të bëhet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi tatimpagues i tatimit mbi pagën, ka nënshkruar deklaratën mbi statusin personal me këtë punëdhënësi, dhe punëdhënësi e ka deklaruar këtë nënshkrim deklarate në rubrikën 30, sipas nenit 66 “Deklarata mbi statusin personal” të këtij ligji.

28. *Baza tatimore mbi të cilën llogaritet TAP* – është diferenca midis pagës bruto të punonjësit, me shumën që zbritet nga paga dhe derdhet nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit, si dhe zbritjet tatimore që përfiton punonjësi sipas nenit 22 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. [(15)-(26)-(27)].

29. *Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi (TAP) gjithsej në lekë* – është shuma e tatimit të llogaritur nga punëdhënësi (agjenti i listëpagesës) për të ardhurat personale nga punësimi i punëmarrësit.

30. *Deklarata e statusit personal* shënohet nga punëdhënësi të cilit punëmarrësi i ka dhënë me shkrim deklaratën e statusit personal, referuar nenit 66 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Punëdhënësi, i cili ka deklaratën e statusit personal të punëmarrësit, do të bëjë zbritjet nga baza tatimore referuar nenit 22, germat “a” deri në “c”, si dhe investimin në fondin e pensionit privat sipas nenit 20, të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

31. *Shënime* – shënohen sqarime për punonjës të veçantë ashtu siç përcaktohet në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014, në kreun për deklarimin e kontributeve për personat ekonomikisht aktivë në dy ose më shumë subjekte, për rastet e zbritjeve nga paga dhe derdhjeve nga punëdhënësi në fondet e pensionit vullnetar si kontribut i punëmarrësit, rastet e llogaritjes së kontributit shtesë për punonjësit e minierave që punojnë në nëntokë, rastet e llogaritjes së kontributit suplementar, si dhe zbritjet nga baza tatimore sipas nenit 22 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

32. *Punonjës që duhet të paguajnë kontribute shoqërore* – shënohet numri i punonjësve të personit juridik dhe personit fizik (përfshirë individin tregtar, të vetëpunësuarin dhe punonjësit e papaguar të familjes) që janë llogaritur të paguajnë kontribute shoqërore sipas listëpagesës, pavarësisht nga shuma



e kontributit. Ky numër nxirret duke numëruar punonjësit bazuar në numrat personale të listëpagesës. Në rastet kur gjatë muajit i njëjti punonjës ka lëvizur brenda tatimpaguesit dhe ka punuar në dy rrethe ai vlerësohet një punonjës. Nuk përfshihen në numrin e “Punonjësve që paguajnë kontribute shoqërore” punonjësit, të cilët për gjithë muajin kanë qenë me raport paaftësie të përkohshme (pas ditës së 14 të raportit), lejë barrë lindjeje etj., të cilët përfitojnë për të gjithë muajin nga skema e sigurimeve shoqërore, të cilët tatimpaguesi duhet t’i mbajë të regjistruar në listëpagesë për deri sa ata nuk kanë shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me të dhe nuk janë deklaruar të larguar nga puna me pasqyrën e ndryshimit të numrit të punonjësve.

33. *Shuma totale e detyrimit për kontributet dhe TAP për t’u paguar (23+25+29)* – është shuma e detyrimit për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve suplementare, të sigurimeve shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, që duhet të paguajë tatimpaguesi për muajin përkatës.

34. *Përfaqësuesi i personit juridik (administratori/administratorët)* – shënohet emri dhe mbiemri i administratorit apo administratorëve aktualë të entitetit (agjenti tatimor).

35. *Deklaruesi (administratori ose personi i autorizuar për deklarin)* / *personi fizik (i autorizuar)* – në rubrikën 35 shënohet emri e mbiemri dhe nënshkrimi elektronik i personit që bën deklarin në formë elektronike të të dhënave të listëpagesës në muajin përkatës. Nga personat juridikë shënohet emri dhe mbiemri i administratorit, ose i personit të autorizuar zyrtarisht, që bën deklarin në formë elektronike të të dhënave të listëpagesës për muajin, si dhe vendoset nënshkrimi elektronik i personit. Nga personat fizikë (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) vendoset emri dhe mbiemri i personit fizik ose personit të autorizuar zyrtarisht prej tij, si dhe vendoset nënshkrimi elektronik i personit. Personat e tjerë të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore (p.sh. kryefamiljari) listëpagesa plotësohet nga individ i apo nga personi i regjistruar në administratë tatimore, që e ka këtë detyrim.

ANEKS 3

FORMULARIT I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA BIZNESI

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA BIZNESI



(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial:

-

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm
(NIPT): Emri i Personit të Tatueshëm:

(3)

Adresa: Qyteti/Bashkia/Rrethi:

(4)

Numri Telefonit:

(5)

(6)

**Llogaritja e rezultatit*****Të ardhurat, zbritjet dhe shpenzimet*****Të ushtrimit****Tatimore****(8/9) Të ardhura nga punësimi****(8)****(9)*****Të ardhura nga biznesi***

(10/11) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor

(10)**(11)**

(12/13) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit

(12)**(13)**

(14/15) Të ardhura nga dividendët

(14)**(15)**

(16/17) Të ardhura të tjera nga investimet

(16)**(17)**

(18/19) Të ardhura të tjera

(18)**(19)****(20/21) Të ardhurat nga biznesi Total****(20)****(21)**

(22) Zbritje nga baza tatimore

Nr. i fëmijëve**(22)**

(23/24) Kompensim për fëmijët në ngarkim

(23)**(24)**

(25) Zbritje shpenzime për arsimimin e fëmijëve

(25)

(26) Zbritje për pensionet private

(26)**(27) Zbritjet Total****(27)****(28) Do të zbatoni regjimin e veçantë për zbritjen e shpenzimeve?****Po ☐****Jo ☐**

(29/30) Shpenzime të llogaritura sipas regjimit të veçantë

(29)**(30)**

(31/32) Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura

(31)**(32)**

(33/34) Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore)

(33)**(34)**

(35/36) Shpenzime administrative

(35)**(36)**

(37/38) Amortizimi

(37)**(38)**

(39/40) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme

(39)**(40)**

(41/42) Shpenzime të tjera financiare

(41)**(42)****(43/44) Shpenzimet Total****(43)****(44)****(45) Shpenzimet e pazbritshme****(45)*****Rezultati***



(46/47) Humbja

(46)

(47)

(48/49) Fitimi

(48)

(49)

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale

(50) Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi

(50)

(51) Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi

(51)

(52) Tatimi mbi të ardhurat personale i shtyrë

(52)

(53) Kreditimi i tatimit të huaj

(53)

(54) Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim

(54)

(55) Tatim mbi të ardhurat personale i detyrueshëm për t'u paguar

(55)

(55)=(50)+(51)-(52)-(53)-(54)

UDHËZUESI I PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA BIZNESI

A. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. *Numri serial* gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të përditësuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.

2. *Periudha tatimore* është vjetore.

3. *Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT)* është numri i dhënë nga QKB-ja dhe që identifikon personin e tatueshëm.

4. *Emri tregtar i personit të tatueshëm* është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it.

5. *Adresa, qyteti, bashkia* tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT – it.

6. *Numri i telefonit* (n.q.s. ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

7. *Kodi i aktivitetit ekonomik dhe përshkrimi* është kodi ekonomik i veprimtarisë së biznesit sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike dhe përshkrimi i veprimtarisë ekonomike që ushtrohet.

B. TË ARDHURAT, ZBRITJET DHE SHPENZIMET**Llogaritja e rezultatit**

8. *Të ardhura nga punësimi (ushtrimore)* janë të ardhurat vjetore nga punësimi të përfituara nga personi fizik (individ i vetëpunësuar) gjatë periudhës ushtrimore.

9. *Të ardhura nga punësimi (tatimore)* janë të ardhurat vjetore nga punësimi të përfituara nga personi fizik (individ i vetëpunësuar) gjatë periudhës tatimore.

Rubrikat 8/9 plotësohen në rastin kur të ardhurat e fituara nga një individ i vetëpunësuar do të konsiderohen të ardhura nga punësimi, sipas parashikimeve të germës “ç”, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 29/2023. Në rastet kur plotësohen rubrikat 8/9, nuk plotësohet rubrikat nga 10 deri 21.

Të ardhura nga biznesi

Rubrikat për të ardhurat nga biznesi, plotësohen nga personi fizik (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar), përveç rasteve kur përmbush kushtet e germës “ç”, të nenit 12, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe plotëson rubrikat 8 dhe 9.



10. Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor (ushtrimore) janë të ardhurat kontabël nga aktiviteti ekonomik kryesor gjatë periudhës ushtrimore.

11. Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor (tatimore) janë të ardhurat e faturuara për aktivitetin ekonomik kryesor që i përkasin periudhës tatimore.

12. Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit (ushtrimore) përfshihen të gjitha të ardhurat e papërfshira në pikën 10, nga aktivitete të tjera të periudhës ushtrimore.

13. Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit (tatimore) përfshihen të gjitha të ardhurat e faturuara të papërfshira në pikën 8, nga aktivitete të tjera të periudhës tatimore.

14. Të ardhura nga dividendi (ushtrimore) janë të ardhurat kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin nga personat fizikë (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) në të cilat ai ka interesa pjesëmarrëse (dividend) gjatë periudhës ushtrimore.

15. Të ardhura nga dividendi (tatimore), janë të ardhurat tatimore nga pjesëmarrja (divident) nga personat fizikë (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) të përcaktuara në nenin 13 të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, gjatë periudhës tatimore.

16. Të ardhura të tjera nga investimet (ushtrimore), janë të ardhurat kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin nga personat fizikë (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas përcaktimeve të neneve 15, 16, 17, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës ushtrimore.

17. Të ardhura të tjera nga investimet (tatimore), janë të ardhurat e përfituara nga personat fizikë (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas përcaktimeve të neneve 15, 16, 17, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës tatimore.

18. Të ardhura të tjera (ushtrimore), janë të ardhurat kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin, që nuk përfshihen në të ardhurat e rubrikave: 9, 11, 13, 15, gjatë periudhës ushtrimore.

19. Të ardhura të tjera (tatimore), janë të ardhurat të tjera që i përkasin periudhës tatimore janë të ardhurat, që nuk përfshihen në të ardhurat e rubrikave: 10, 12, 14, 16, gjatë periudhës tatimore.

20. Të ardhurat nga biznesi total (ushtrimore), janë shuma e të ardhurave nga rubrikat ushtrimore: 10, 12, 14, 16, 18.

21. Të ardhurat nga biznesi total (tatimore), janë shuma e të ardhurave nga rubrikat tatimore: 11, 13, 15, 17, 19.

22. Zbritje nga baza tatimore plotësohet nga personi fizik i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi dhe/ose biznesi sipas germave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 22, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

23. Kompensim për fëmijët në ngarkim (ushtrimore) numri i fëmijëve në ngarkim më pak se 18 vjeç.

24. Kompensim për fëmijët në ngarkim (tatimore) shumë shuma e kompensimit për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç sipas përcaktimit në germën “ç”, të nenit 22, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

25. Zbritje shpenzime për arsimimin e fëmijëve janë shpenzimet korrente për arsimimin e fëmijëve në ngarkim të tij. Personi fizik me të ardhura vjetore të tatueshme nga punësimi dhe/ose të ardhura vjetore të tatueshme nga biznesi, plotëson këtë rubrikë me kushtin që të ardhurat vjetore të jenë më pak se 1 200 000 lekë.

Shënim. Bazuar në pikën 1, të nenit 23 të ligjit nr. 29/2023, kompensimi sipas rubrikave 23, 24 dhe 25, në rastin kur plotësohen kushtet e nenit 22, të ligjit, kërkohet nga anëtar i familjes me të ardhurat më të larta vjetore. Nëse të ardhurat e personit fizik nuk janë të ardhurat më të larta vjetore në familje këto rubrika plotësohen me 0.

26. Zbritje për pensionet private janë kontributi vjetor i derdhur në fondin e pensionit privat me kushtin që kufiri maksimal mujor për lehtësitë tatimore të mos kalojë nivelin e pagës minimale mujore të miratuar në shkallë vendi.

27. Zbritjet total është shuma e rubrikave: 22, 24, 25, 26.

28. “Do të zbatoni regjimin e veçantë për zbritjen e shpenzimeve?” – shënjesë. Personat fizikë (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) me qarkullim vjetor deri në 10 000 000 lekë, bazuar në nenin 14 të ligjit, kanë të drejtën për të zgjedhur ose jo regjimin e veçantë për zbritjen e shpenzimeve. Këto shpenzime mund të zbriten apriori ose bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive për çdo shpenzim. Me qëllim **zgjedhjen** e metodës të cilën do të zbatojë, personi fizik do të shënjojë “po” për zbriten apriori të



shpenzimeve ose “jo” për të mos i zbritur apriori shpenzimet, por bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive. Pasi zgjidhet një herë, kjo metodë nuk mund të ndryshohet për një periudhë trevjeçare.

Sqarim. Kur plotësohet rubrika 28 me “PO”, personi fizik (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) zgjedh regjiin e veçantë me shpenzime të supozuara që zbriten apriori dhe në këtë rast plotësohet automatikisht rubrika 29 dhe 30. Plotësimi automatik bëhet referuar të dhënave në rubrikën 20 dhe 21. Nuk mund të zgjidhet rubrika 28 me “PO” në rast se të ardhurat sipas rubrikës 20 dhe 21 janë më shumë se 10.000.000 lekë.

Rubrika 29 dhe 30 llogaritet automatikisht në % përkatëse përcaktuar në nenin 14 të ligjit “Për tatim mbi të ardhurat”.

29. *Shpenzime të llogaritura sipas regjimit të veçantë (ushtrimore)* është përqindja (%) në raport me të ardhurat e rubrikës 20, sipas përcaktimit në nenin 14 të ligjit “Për tatim mbi të ardhurat”.

30. *Shpenzime të llogaritura sipas regjimit të veçantë (tatimore)* është përqindja (%) në raport me të ardhurat e rubrikës 21, sipas përcaktimit në nenin 14 të ligjit “Për tatim mbi të ardhurat”.

31. *Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura (ushtrimore)* janë shpenzimet kontabël të përlllogaritura nga personi fizik (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) në lidhje me kostot e mallrave, produkteve apo shërbimeve gjatë periudhës ushtrimore.

32. *Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura (tatimore)* janë shpenzimet e dokumentuara lidhur me kostot e mallrave, produkteve apo shërbimeve gjatë periudhës tatimore.

33. *Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore) (ushtrimore)* janë shpenzimet e përlllogaritura sipas ligjit për kontabilitetin lidhur me pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera lidhur me personelin gjatë periudhës ushtrimore.

34. *Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore) (tatimore)* janë shpenzimet e përlllogaritura lidhur me pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera lidhur me personelin gjatë periudhës tatimore.

35. *Shpenzime administrative (ushtrimore)* janë shpenzime të llogaritura nga personi fizik, (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas përcaktimeve në ligjin për kontabilitetin dhe të pasqyruara në PASH, gjatë periudhës ushtrimore.

36. *Shpenzime administrative (tatimore)* janë shpenzime të llogaritura nga personi fizik (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas përcaktimeve në ligjin për kontabilitetin dhe të pasqyruara në PASH, të cilat shërbejnë për sigurimin dhe ruajtjen e së ardhurës së tatueshme, gjatë periudhës tatimore.

37. *Amortizimi (ushtrimore)* është përlllogaritje e shpenzimeve nga personi fizik (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas parimeve të ligjit për kontabilitetin i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të aktiveve, gjatë periudhës ushtrimore.

38. *Amortizimi (tatimore)* është përlllogaritje e shpenzimeve nga personi fizik (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas parimeve të ligji për kontabilitetin i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim me metodën lineare gjatë periudhës tatimore, duke respektuar kushtet e nenit 51 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

39. *Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme (ushtrimore)* janë shpenzime të përlllogaritura nga personi fizik, (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas ligjit për kontabilitetin për interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH gjatë periudhës ushtrimore.

40. *Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme (tatimore)* janë shpenzime të përlllogaritura nga personi fizik, (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) për interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH, gjatë periudhës tatimore.

41. *Shpenzime të tjera financiare (ushtrimore)* janë shpenzime financiare të përlllogaritura nga personi fizik, (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) sipas ligjit për kontabilitetin që nuk përfshin interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH gjatë periudhës ushtrimore.

42. *Shpenzime të tjera financiare (tatimore)* janë shpenzime financiare të përlllogaritura nga personi fizik, (individ tregtar apo individ i vetëpunësuar) që nuk përfshin interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH, sipas ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës tatimore.



43. *Shpenzimet total (ushtrimore)* janë shuma e shpenzimeve të llogaritura nga personi fizik (individ i tregtar apo individ i vetëpunësuar) referuar rubrikave: 31, 33, 35, 37, 39, 41 gjatë periudhës ushtrimore.

44. *Shpenzimet total (tatimore)* janë shuma e shpenzimeve të llogaritura nga personi fizik, (individ i tregtar apo individ i vetëpunësuar) referuar rubrikave 32, 34, 36, 38, 40, 42 gjatë periudhës tatimore.

45. *Shpenzimet e pazbritshme* janë shpenzime të cilat nuk i kanë shërbyer drejtpërsëdrejti ushtrimit të aktivitetit, si dhe plotësojnë kushtet e nenit 50 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Rezultati nga biznesi

46. *Humbja (ushtrimore)* është diferenca midis shumës së shpenzimeve ushtrimore dhe shumës së të ardhurave ushtrimore, në rastin kur janë plotësuar rubrikat 8 dhe 9 të deklarës llogaritet $(46)=(43)-(8)$ me kushtin që $(43)>(8)$, ndërsa në rastin kur janë plotësuar rubrikat 10 deri 21 të deklarës llogaritet $(46)=(43)-(20)$ me kushtin që $(43)>(20)$.

47. *Humbja (tatimore)*: do të llogaritet bazuar në rubrikat e plotësuara dhe të zgjedhura të deklarës:

- **Kur janë plotësuar rubrikat 8 dhe 9 të deklarës, konkretisht “Të ardhura nga punësimi” humbja tatimore do të jetë:**

- në rastin kur është zgjedhur regjimi tatimor i veçantë (shënjuar “po” rubrika 28) është diferenca midis shumës së shpenzimeve tatimore dhe shumës së të ardhurave tatimore $(47) = (30)-(9)+(27)$, me kushtin që $[(30)+(27)]>(9)$;

- në rastin kur është zgjedhur njohja e shpenzimeve bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive (shënjuar “jo” rubrika 28), si dhe në rastet kur tatimpaguesi është me qarkullim vjetor mbi 10,000,000 lekë fitimi tatimor llogaritet është diferenca midis shumës së shpenzimeve tatimore dhe shumës së të ardhurave tatimore përfshirë shpenzimet e pazbritshme $(47) = (44)-(45)-(9)+(27)$, me kushtin që $[(44)-(45)+(27)]>(9)$.

- **Kur janë plotësuar rubrikat 10 deri 21 të deklarës, konkretisht “Të ardhura nga biznesi” humbja tatimore do të jetë:**

- në rastin kur është zgjedhur regjimi tatimor i veçantë (shënjuar “po” rubrika 28) është diferenca midis shumës së shpenzimeve tatimore dhe shumës së të ardhurave tatimore $(47) = (30)-(21)+(27)$, me kushtin që $[(30)+(27)]>(21)$;

- në rastin kur është zgjedhur njohja e shpenzimeve bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive (shënjuar “jo” rubrika 28), si dhe në rastet kur tatimpaguesi është me qarkullim vjetor mbi 10,000,000 lekë fitimi tatimor llogaritet është diferenca midis shumës së shpenzimeve tatimore dhe shumës së të ardhurave tatimore përfshirë shpenzimet e pazbritshme $(47) = (44)-(45)-(21)+(27)$, me kushtin që $[(44)-(45)+(27)]>(21)$.

48. *Fitimi (ushtrimor)* është diferenca midis shumës së të ardhurave ushtrimore me shumën e shpenzimeve ushtrimore, në rastin kur janë plotësuar rubrikat 8 dhe 9 të deklarës llogaritet $(48)=(8)-(43)$ me kushtin që $(8)>(43)$, ndërsa në rastin kur janë plotësuar rubrikat 10 deri 21 të deklarës llogaritet $(48) = (20)-(43)$ me kushtin që $(20)>(43)$.

49. *Fitimi (tatimor)*, do të llogaritet bazuar në rubrikat e plotësuara dhe të zgjedhura të deklarës:

- **Kur janë plotësuar rubrikat 8 dhe 9 të deklarës, konkretisht “Të ardhura nga punësimi” fitimi tatimor do të jetë:**

- në rastin kur është zgjedhur regjimi tatimor i veçantë (shënjuar “po” rubrika 28) fitimi është diferenca midis shumës së të ardhurave tatimore dhe shumës së shpenzimeve tatimore $(49)=(9)-(27)-(30)$ me kushtin që $[(9)-(27)]>(30)$,

- në rastin kur është zgjedhur njohja e shpenzimeve bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive (shënjuar “jo” rubrika 28), si dhe në rastet kur tatimpaguesi është me qarkullim vjetor mbi 10,000,000 lekë fitimi tatimor llogaritet është diferenca midis shumës së të ardhurave tatimore, shpenzimeve jo të zbritshme dhe shumës së shpenzimeve tatimore, $(49)=(9)-(27)-(44)+(45)$ me kushtin që $[(9)-(27)+(45)]>(44)$.

- **Kur janë plotësuar rubrikat 10 deri 21 të deklarës, konkretisht “Të ardhura nga biznesi” fitimi tatimor do të jetë:**



- në rastin kur është zgjedhur regjimi tatimor i veçantë (shënuar “po” rubrika 28) fitimi është diferenca midis shumës së të ardhurave tatimore dhe shumës së shpenzimeve tatimore $(49)=(21)-(27)-(30)$ me kushtin që $[(21)-(27)] > (30)$;

- në rastin kur është zgjedhur njohja e shpenzimeve bazuar në dokumentacionin dhe faturat respektive (shënuar “jo” rubrika 28), si dhe në rastet kur tatimpaguesi është me qarkullim vjetor mbi 10,000,000 lekë fitimi tatimor llogaritet është diferenca midis shumës së të ardhurave tatimore, shpenzimeve jo të zbritshme dhe shumës së shpenzimeve tatimore, $(49)=(21)-(27)-(44)+(45)$ me kushtin që $[(21)-(27)+(45)] > (44)$,

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale

50. *Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi* është shuma e tatimit të llogaritur mbi të ardhurat personale nga biznesi sipas pikës 2, të nenit 24, të ligjit “Për tatim mbi të ardhurat”. Në rastet kur të ardhurat bruto të personit fizik janë deri në 14 milionë lekë në vit, deri në 31 dhjetor 2029, norma tatimore që do të aplikohet mbi të ardhurat personale nga biznesi do të jetë 0% dhe tatimi i llogaritur zero lekë.

51. *Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi* është shuma e tatimit të llogaritur mbi të ardhurat nga punësimi sipas pikës 1, të nenit 24, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ky tatim llogaritet vetëm në rastet kur plotësohen rubrikat 8 dhe 9.

52. *Tatimi mbi të ardhurat personale i shtyrë* është shuma e llogaritur e tatimit të personit fizik (individi tregtar apo individ i vetëpunësuar) e cila për shkak të lehtësive tatimore (nëse ka) nuk duhet të paguhet në organet tatimore, por vetëm të rezervohet dhe të paguhet në rast të thyerjes së kushtit për të cilin është përfituar lehtësia tatimore.

53. *Kreditimi i tatimit të huaj* është shuma e tatimit të huaj të paguar për të ardhurat tatimore që personi fizik, (individi tregtar apo individ i vetëpunësuar) realizon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës tatimore. Shuma e tatimit të huaj të kredituar nuk mund të kalojë shumën e tatimit të pagueshëm sikur këto të ardhura të realizoheshin në Republikën e Shqipërisë.

54. *Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim*, është shuma e tatimit të mbajtur dhe paguar në zbatim të nenit 58, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, e cila kreditohet për tatimpaguesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

55. *Tatim mbi të ardhurat personale i detyrueshëm për t’u paguar* është shuma e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/tatimi mbi të ardhurat nga punësimi minus tatimi mbi të ardhurat personale i shtyrë, kreditimi i tatimit të huaj, Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim $(55)=(50)+(51)-(52)-(53)-(54)$.

ANEKS 4

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS
FORMULARI I DEKLARIMIT DHE I
PAGESËS SË TATIMIT MBI TË
ARDHURAT E KORPORATËS



(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial:

-

Numri Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT):

(3) _____

Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:

(4) _____

Adresa: Qyteti/Bashkia/Rrethi:

(5) _____

**Llogaritja e rezultatit****Të ardhurat dhe shpenzimet**

(7/8) Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor

(9/10) Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit

(11/12) Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe ose dividendi

(13/14) Të ardhura nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata

(15/16) Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme

(17/18) Të ardhura të tjera që nuk përfshihen në rubrikat më lart

(19/20) Të ardhurat Total

Të ushtrimit	Tatimore
(7)	(8)
(9)	(10)
(11)	(12)
(13)	(14)
(15)	(16)
(17)	(18)
(19)	(20)

(21/22) Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura

(23/24) Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore)

(25/26) Shpenzime administrative

(27/28) Amortizimi

(29/30) Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme

(31/32) Shpenzime të tjera financiare

(33/34) Shpenzime të tjera

(35/36) Shpenzimet total

(21)	(22)
(23)	(24)
(25)	(26)
(27)	(28)
(29)	(30)
(31)	(32)
(33)	(34)
(35)	(36)

(37) Shpenzimet e pazbritshme

(37)

Rezultati

(38/39) Humbja (38)= (35)-(19) kur (35)>(19)

(39)=(36)-(37)-(20) kur (36)-(37)>(20)

(40/41) Fitimi (40)= (19)-(35) kur (19)>(35)

(41)=(20)+(37)-(36) kur (20)+(37)>(36)

(42) Humbje e mbartur

(43) Fitimi i tatueshëm neto (39)=(37)-(38)

(38)	(39)
(40)	(41)
	(42)
	(43)

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës
☐ Përcakto vlerën për kuti
(44) (46) (48)

Baza e tatueshme

Tatimi



(44/45) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%	(44)	(45)
(46/47) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të reduktuar 5%	(46)	(47)
(48/49) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera	(48)	(49)
(50) Totali i tatimit		(50)
(51) Kreditimi i tatimit të huaj		(51)
(52) Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim		(52)
(53) Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë		(53)
(54) Tatim mbi të ardhurat e korporatës i detyrueshëm për t'u paguar (54)=(50)-(51)-(52)- (53)		(54)

A. UDHËZUESI I PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS

B. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. *Numri serial* gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të përditësuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.

2. *Periudha tatimore* është vjetore.

3. *Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT)* është numri i dhënë nga QKB dhe që identifikon personin e tatueshëm.

4. *Emri tregtar i personit të tatueshëm* është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it.

5. *Adresa* tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT – it.

6. *Numri i telefonit* (nëse ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

C. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Llogaritja e rezultatit

7. *Të ardhurat nga aktiviteti ekonomik kryesor (ushtrimore)* janë të ardhurat kontabël nga aktiviteti ekonomik kryesor gjatë periudhës ushtrimore.

8. *Të ardhura nga aktiviteti ekonomik kryesor (tatimore)* janë të ardhurat e faturuara për aktivitetin ekonomik kryesor që i përkasin periudhës tatimore.

9. *Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit*, përfshihen të gjitha të ardhurat e papërfshira në pikën 7, nga aktivitete të tjera të periudhës ushtrimore.

10. *Të ardhura nga aktivitete të tjera dhe të ardhura të tjera të shfrytëzimit*, përfshihen të gjitha të ardhurat e faturuara të papërfshira në pikën 8, nga aktivitete të tjera të periudhës tatimore.

11. *Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe/ose dividendi*, janë të ardhurat kontabile të përllogaritura sipas ligjit për kontabilitetin nga entiteti në të cilat ai ka interesa pjesëmarrëse gjatë periudhës ushtrimore.

12. *Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse dhe/ose dividendi*, janë të ardhurat tatimore nga entitetet ku kanë interesa në pjesëmarrje dhe/ose dividendi dhe të cilat nuk plotësojnë kriteret e përjashtimit nga fitimi i tatueshëm referuar përcaktimeve në nenin 29, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

13. *Të ardhura nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (ushtrimore)*, janë të ardhurat kontabël të përllogaritura sipas ligjit për kontabilitetin nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata gjatë periudhës ushtrimore.



14. *Të ardhura nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (tatimore)*, janë të ardhurat tatimore nga investimet dhe huat e tjera pjesë e aktiveve afatgjata gjatë periudhës tatimore

15. *Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme*, janë të ardhurat kontabël të përlogaritura nga entiteti sipas ligjit për kontabilitetin nga interesat dhe të ardhura të tjera të ngjashme gjatë periudhës ushtrimore.

16. *Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme*, janë të ardhurat tatimore të përlogaritura nga entiteti nga interesat dhe të ardhura të tjera të ngjashme gjatë periudhës tatimore.

17. *Të ardhura të tjera që nuk përfshihen në rubrikat e tjera gjatë periudhës ushtrimore* janë të ardhurat kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin, që nuk përfshihen në të ardhurat e rubrikave: 7, 9, 11, 13, 15.

18. *Të ardhura të tjera që nuk përfshihen në rubrikat e tjera gjatë periudhës tatimore* janë të ardhurat tatimore të përlogaritura nga entiteti gjatë periudhës tatimore, që nuk përfshihen në të ardhurat e rubrikave: 8, 10, 12, 14, 16.

19. *Të ardhurat total (ushtrimore)* janë shuma e të ardhurave nga rubrikat ushtrimore 7 + 9+11+13+15+17.

20. *Të ardhurat total (tatimore)* janë shuma e të ardhurave nga rubrikat tatimore 8+10+12+14+16+18.

21. *Kosto e mallrave, produkteve apo shërbimeve të shitura (ushtrimore)* janë shpenzimet kontabël të përlogaritura nga entiteti në lidhje me kostot e mallrave, produkteve apo shërbimeve gjatë periudhës ushtrimore, sipas PASH.

22. *Kosto e mallrave, produkteve, apo shërbimeve të shitura (tatimore)* janë shpenzimet lidhur me kostot e mallrave, produkteve apo shërbimeve gjatë periudhës tatimore, sipas PASH-it.

23. *Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore) (ushtrimore)* janë shpenzimet e përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin lidhur me pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera lidhur me personelin gjatë periudhës ushtrimore.

24. *Shpenzime të punës (paga + sigurime shoqërore e shëndetësore (tatimore)* janë shpenzimet e përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin lidhur me pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzime të tjera lidhur me personelin gjatë periudhës tatimore.

25. *Shpenzime administrative (ushtrimore)* janë shpenzime të llogaritura nga entiteti sipas përcaktimeve në ligjin për kontabilitetin dhe të pasqyruara në PASH, gjatë periudhës ushtrimore.

26. *Shpenzime administrative (tatimore)* janë shpenzime të llogaritura nga entiteti sipas përcaktimeve në ligjin për kontabilitetin dhe të pasqyruara në PASH, të cilat shërbejnë për sigurimin dhe ruajtjen e së ardhurës së tatueshme, gjatë periudhës tatimore.

27. *Amortizimi (ushtrimore)* është përlogaritje e shpenzimeve nga entiteti sipas parimeve të ligjit për kontabilitetin i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të aktiveve, gjatë periudhës ushtrimore.

28. *Amortizimi (tatimore)* është përlogaritje e shpenzimeve nga entiteti sipas parimeve të ligjit për kontabilitetin i cili njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si shpenzim me metodën lineare gjatë periudhës tatimore, duke respektuar kushtet e nenit 51, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

29. *Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme (ushtrimore)* janë shpenzime të përlogaritura nga entiteti sipas ligjit për kontabilitetin për interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH gjatë periudhës ushtrimore.

30. *Shpenzime interesi dhe shpenzime të tjera të ngjashme (tatimore)* janë shpenzime të përlogaritura nga entiteti për interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH, referuar kufizimeve të përcaktuara në nenin 30 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës tatimore.

31. *Shpenzime të tjera financiare (ushtrimore)* janë shpenzime financiare të përlogaritura nga entiteti sipas ligjit për kontabilitetin që nuk përfshin interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH gjatë periudhës ushtrimore.

32. *Shpenzime të tjera financiare (tatimore)* janë shpenzime financiare të përlogaritura nga entiteti që nuk përfshin interesat dhe shpenzimet e tjera të ngjashme të pasqyruara në PASH, sipas përcaktimeve të nenit 31 të ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, gjatë periudhës tatimore.



33. *Shpenzime të tjera (ushtrimore)* janë shpenzime kontabël të përlogaritura sipas ligjit për kontabilitetin, që nuk përfshihen në rubrikat: 21, 23, 25, 27, 29, 31.

34. *Shpenzime të tjera (tatimore)* janë shpenzime tatimore të përlogaritura nga entiteti, që nuk përfshihen në rubrikat 22, 24, 26, 28, 30, 32.

35. *Shpenzimet total (ushtrimore)* janë shuma e shpenzimeve të llogaritura nga entiteti referuar rubrikave 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33 gjatë periudhës ushtrimore.

36. *Shpenzimet total (tatimore)* janë shuma e shpenzimeve të llogaritura nga entiteti referuar rubrikave 22, 24, 26, 28, 30, 32, 34 gjatë periudhës tatimore.

37. *Shpenzimet e pazbritshme* janë shpenzime të cilat nuk i kanë shërbyer drejtpërsëdrejti ushtrimit të aktivitetit, si dhe plotësojnë kushtet e nenit 50 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Rezultati

38. *Humbja (ushtrimore)* është diferenca midis shumës së shpenzimeve ushtrimore dhe shumës së të ardhurave ushtrimore $(38) = (35) - (19)$, me kushtin që $(35) > (19)$.

39. *Humbja (tatimore)* është diferenca midis shumës së shpenzimeve tatimore dhe shumës së të ardhurave tatimore përfshirë shpenzimet e pazbritshme $(39) = (36) - (37) - (20)$, me kushtin që $[(36) - (37)] > (20)$.

40. *Fitimi (ushtrimor)* është diferenca midis shumës së të ardhurave ushtrimore me shumën e shpenzimeve ushtrimore $(40) = (19) - (35)$ kur $(19) > (35)$.

41. *Fitimi (tatimor)* është diferenca midis shumës së të ardhurave tatimore plus shpenzimeve jo të zbritshme me shumën e shpenzimeve tatimore. $(41) = (20) + (37) - (36)$, me kushtin që $[(20) + (37)] > (36)$.

42. *Humbje e mbartur* është humbja e mbartur nga periudhat paraardhëse dhe që njihet për efekte tatimore për t’u mbuluar nga fitimet e periudhës që deklarohet. Shuma e mbartur nuk mund të kalojë fitimin e periudhës tatimore. $42 \leq 41$.

43. *Fitimi i tatueshëm*, është fitimi tatimor duke zbritur humbjen e mbartur (nëse ka). $(43) = (41) - (42)$.

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat e korporatës.

Përzgjedhja e kutizës me përmbajtjen: “Përcakto vlerën për kuti (44) (46) (48)”, do të bëhet në rastet kur, tatimpaguesi do të zbatojë shkallë tatimore të ndryshme nga ato standarde ose do të zbatojë disa shkallë tatimore.

44. *Baza e tatueshme*, është fitimi i tatueshëm mbi të cilin do të zbatohet shkalla standarde tatimore 15%.

45. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore standarde 15%* është shuma e tatim fitimit korporativ e llogaritur për vitin tatimor me shkallën standarde 15% për entitetet me të ardhura mbi 14 (katëmbëdhjetë) milionë lekë.

46. *Baza e tatueshme*, është fitimi i tatueshëm mbi të cilin do të zbatohet shkalla standarde tatimore 5%.

47. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të reduktuar 5%*, është shuma e tatim fitimit korporativ e llogaritur për vitin tatimor me shkallën e reduktuar 5%, për entitetet e përcaktuara në nenin 69 (lehtësitë tatimore) të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

48. *Baza e tatueshme*, është fitimi i tatueshëm mbi të cilin do të zbatohen shkallët tatimore me përqindje të tjera (nëse ka), të ndryshme nga shkallët standarde tatimore.

49. *Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera* është shuma e tatim fitimit korporativ e llogaritur për vitin tatimor me shkallët tatimore të tjera të ndryshme nga shkallët standarde tatimore.

50. *Totali i tatimit*, është shuma totale e tatimeve të llogaritura me të gjitha shkallët tatimore që janë zbatuar. $50 = 45 + 47 + 49$.

51. *Kreditimi i tatimit të huaj* është shuma e tatimit të huaj të paguar për të ardhurat tatimore që entiteti realizon jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës tatimore. Shuma e tatimit të huaj të kredituar nuk mund të kalojë shumën e tatimit të pagueshëm sikur këto të ardhura të realizoheshin në Republikën e Shqipërisë.

52. *Kreditimi i tatimit të mbajtur në burim*, është shuma e tatimit të mbajtur dhe paguar në zbatim të nenit 58, të ligjit për tatimin mbi të ardhurat, e cila kreditohet për tatimpaguesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë.



53. Tatimi mbi të ardhurat e korporatës i shtyrë është shuma e llogaritur e tatimit korporativ, e cila për shkak të lehtësive tatimore (nëse ka) nuk duhet të paguhet në organet tatimore, por vetëm të rezervohet dhe të paguhet në rast të thyerjes së kushtit për të cilin është përfituar lehtësia tatimore.

